


EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5928
E martë, 12 nëntor 2019
çmimi 0.40 €

Studentëve të arsimit privat u mundësohet praktika në ShSKUK

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP) KA URDHËRUAR KQZ-NË QË T'I RINUMËROJË 1 472 VENDVOTIME SI DHE TË MOS I PËRFSHIJË NË REZULTAT VOTAT E ARDHURA NGA SERBIA

FAQE 3

PZAP-i ANULON VOTAT NGA SERBIA, KOALICIONI NISMA-AKR-PD PJESË E KUVENDIT



Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka kërkuar nga KQZ-ja që t'i largojë nga rezultati përfundimtar i zgjedhjeve të 6 tetorit fletëvotimet e ardhura nga Serbia dhe ta bëjë rinumërimin e 1 472 vendvotimeve. Këto dy vendime të PZAP-it kanë ardhur pas ankesave të koalicionit Nisma-AKR-PD dhe të disa partive dhe kandidatëve për deputetë. Këtë vendim e ka përshëndetur koalicioni Nisma-AKR-PD, kurse e kanë kritikuar Lëvizja Vetëvendosje dhe Lista Serbe. Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, në një konferencë për media ka bërë me dije se me anulimin e votave nga Serbia koalicioni Nisma-AKR-PD ka kaluar pragun zgjedhor. Ai ka thënë se PZAP-i me këtë vendim tregoi se është gardian i mbrojtjes së demokracisë

IDEJA E SHENGENIT BALLKANIK KA NGJALLUR REAGIME TË SHUMTA NË KOSOVË DHE MË GJERË

Kosova kundër minishengenit

Njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të integritimit evropian e kanë kundërshtuar nismën e Shengenit Ballkanik. Blerim Reka, Lisen Bashkurti, Sabri Kiçmari dhe Vigan Qorrolli kanë

vlerësuar se kjo iniciativë rajonale është e dëmshme për Republikën e Kosovës dhe duhet të refuzohet. Sipas tyre, pas kësaj nisme fshihen shumë të panjohura që nuk e marrin për bazë realitetin politik të

Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran. "Është një lëvizje emocionale dhe jo e menduar mirë në rrafshin strategjik. Është një lëvizje ndarëse ballkanike", ka thënë ish-ambasadori Kiçmari

FAQE 4-5



OPINION

EKSPERTIZA ZVICERANE ZHVESH FSHEHJEN E KRIMIT PËR RASTIN 'ASTRIT DEHARI'

F. 06

Shkruan:
Bardhyl
MAHMUTI



DY FJALË PËR DREJTORIN, MIKUN, KOLEGUN ROLAND KAÇANI - 'LANDI'

F. 12

Bali MAHMUTI

AKTUALE

MPJ E CILËSON TË RREMË LAJMIN PËR TËRHEQJEN E NJOHJES SË KOSOVËS NGA GANA

F. 3

NGA 25 NËNTORI FILLON FURNIZIMI ME TARGA

F. 6

EKONOMI

KUSHTET EKONOMIKE DHE MIGRIMI, NDËR FAKTORËT QË ULËN NATALITETIN NË KOSOVË

F. 7

ÇMIMET E KONSUMIT SHËNUAN RITJE PËR 2.2 PËR QIND

F. 7

MINATORËT E 'TREPÇËS' NISIN GREVËN

F. 7

SPORT

GCHALLANDESI: NDAJ ÇEKISË LUAJMË PËR FITORE

F. 9

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Leyen: Të hapen negociatat me Shqipërinë

BERLIN, 11 NËNTOR - Emmanuel Macron i hapi derën Rusisë në Ballkanin Perëndimor pasi bllokoj bisedimet e anëtarësimit për Shqipërinë dhe Maqedoninë e veriut, ka deklaruar Ursula Von Der Leyen.

Presidentja e zgjedhur e Komisionit Evropian Von Der Leyen i nxit liderët e bllokut që t'i nisnin bisedimet menjëherë. Argumenti i saj ishte se Rusia, Kina, Turqia apo Arabia Saudite mund të zënë hapësirën e lënë bosh nëse BE-ja nuk bën një rivlerësim të vetes në rajon.

Von der Leyen shfrytëzoi fjalimin e mbajtur me rastin e 30-vjetorit të rënies së Murit të Berlinit për të

kujtuar se Evropa iu kërkoi shumë Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, dhe ato i përmbushën të gjitha.

"Tani duhet t'i qëndrojmë fjalës tonë dhe të nisim bisedimet e anëtarësimit", ishte komenti i Von der Leyen. Fjalimi vazhdoi me nënvizimin e faktit që krerët e BE-së e vonuan perspektivën e anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor që në 2003-shin. "Ideja asokohe ishte të ankronim në rajon idenë e paqes, që ishte tronditur nga një konflikt i përgjakshëm. Dhe historia e BE-së që nga viti 1989, ka treguar se çfarë përfitimesh ka, kur unioni ynë e hap zemrën e tij", ka qenë

komenti i politikanës veterane që pret të zyrtarizohet në krye të krahut ekzekutiv të bllokut evropian.

Macron ishte i vetmi udhëheqës i Bashkimit Evropian që bllokoj nisjen e bisedimeve të anëtarësimit për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, thekson shtypi britanik, i cili ka përcjell qëndrimin e Von Der Leyen.

Artikulli risjell edhe fjalët e shefit të Elizesë në intervistën e dhënë për "The Economist", ku i mëshonte idesë se Brukseli duhet t'i reformonte procedurat e tij të anëtarësimit, një proces ky që sipas tij, nuk është më i përshtatshëm për qëllimin e vet.



Trumpi i vendosur të takohet me Erdoganin

Me gjithë kritikën e demokratëve, presidenti amerikan Donald Trump do të presë më 13 nëntor në Shtëpinë e Bardhë homologun e tij turk, Recep Tayyip Erdogan

WASHINGTON, 11 NËNTOR - Presidenti amerikan Donald Trump do të presë më 13 nëntor në Shtëpinë e Bardhë homologun e tij turk, Recep Tayyip Erdogan. Vizita vjen vetëm disa javë pas ofensivës turke kundër luftëtarëve kurdë në Siri, të cilët për një kohë të gjatë ishin aleatë të Shteteve të Bashkuara në luftën kundër terroristëve të Shtetit Islamik. Ligjvënës në ShBA nga radhët e të dyja partive e kritikuan presidentin Trump për tërheqjen e trupave amerikane nga Siria. Demokratët kritikuan edhe ftesën për vizitë të Erdoganit, ndërkohë që Turqia vazhdon të sulmojë kurdët. Sulmet e Turqisë kundër forcave kurde në veri të Sirisë nxitën thirrjet e shumë anëtarëve të Kongresit që Shtetet e Bashkuara të ndër marrin sanksione të fuqishme ekonomike ndaj Turqisë.

"Do të vazhdojmë thirrjet për sanksione ekonomike, të cilat do të veprojnë për aq kohë sa qeveria e Erdoganit sulmon aleatët tanë në luftën kundër ISIS-it, Forcat Demokratike Siriane", i tha shërbimit turk të "Zërit të Amerikës" senatori demokrat Chris Van Hollen.

Një senator tjetër i kërkoi presidentit Donald Trump që t'i tregojë Kongresit, se si do të sigurohet që Shteti Islamik nuk është ringjallur pas tërheqjes së trupave amerikane. Senatori Chuck Schumer e bëri po ashtu të qartë se nuk pajtohet me ftesën e Trumpit për presidentin turk Erdogan.

"Sinjerisht, është e habitshme se si presidenti Trump po i shtron qilimin e mirëseardhjes një autokraci, veprimet e fundit të të cilit kërcënuan aleatët dhe partnerët tanë", tha senatori demokrat Chuck Schumer. Presidenti Trump i dërgoi letër



homologut të tij Erdogan ditën kur filloi ofensiva turke, muajin e kaluar, ku thuhej "Mos luaj të fortin. Mos u bëj i marrë". Erdoganin e quajti letrën akt të pasjellshëm. Prandaj, ishte e paqartë nëse vizita në Shtëpinë e Bardhë do të realizohej. Por ekspertët thonë se me

gjithë kritikën për mundësinë e krimeve të luftës në Siri, të dy presidentët Trump dhe Erdogan shprejnë të riafirmojnë lidhjet e vjetra midis dy vendeve aleate të NATO-s.

"Kur hedh sytë nga Shtetet e Bashkuara, presidenti Erdogan shikon vetëm një mik në të gjithë vendin. Për fatin e tij,

është një mik shumë i rëndësishëm, është presidenti i Shteteve të Bashkuara. Trumpi sheh një udhëheqës në Turqi, me të cilin pajtohet, për çfarëdo arsye, ndoshta sepse kanë një botëkuptim të ngjashëm në jetë", thotë eksperti Alan Makovsky i Qendrës për Zhvillimin Amerikan.

Basha: Sektori i biznesit në luftë për mbijetesë

TIRANË, 11 NËNTOR - Kryedemokrati Lulzim Basha ka zhvilluar një takim me bizneset prodhuese në Durrës, ku theksoi se sektori i biznesit në luftë për mbijetesë. "Po mbytet nga politikat e gabuara të kësaj qeverie. Kemi klimën më të keqe të biznesit në Evropë. Për mua, një biznes i çliruar

është vizioni për një biznes të suksesshëm. Ju duhet një qeveri që nuk ua bën jetën më të vështirë por më të lehtë. Ne jemi për taksa më të ulëta dhe ulje të korrupsionit. Ky është në themel të vizionit tonë.

Po tregohemi me gisht si qendra e krimin dhe drogës, ne do të punojmë që të tregohemi si qendra e suksesit të ekonomisë

dhe biznesit", tha Basha. Ndërsa bizneset shprehen shqetësimet për barrën fiskale, veçanërisht për tatim fitimit dhe kostot e prodhimit. "Të ketë reformim të inspektoratit, jo të na vijin 30 lloje inspektorësh. Të krijohet zona të lira biznesi", ishin kërkesat e biznesit.

"Të orientohet tregu dhe të

stimulohet biznesi që të prodhojmë për eksportin. Duhet të garantohet prodhimi i lëndës së parë tekstile, sepse e importojmë nga Kina dhe kjo sjell kosto. Nëse sigurohet lënda e parë nuk mbetemi skllëvërt kompanive të huaja por sigurojmë prod-

him made in Albania për tregun tonë", thekson biznesi fason.



Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka urdhëruar KQZ-në që t'i rinumërojë 1 472 vendvotime si dhe të mos i përfshijë në rezultat votat e ardhura nga Serbia

PZAP-i anulon votat nga Serbia, koalicioni Nisma-AKR-PD pjesë e Kuvendit



Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka kërkuar nga KQZ-ja që t'i largojë nga rezultati përfundimtar i zgjedhjeve të 6 tetorit fletëvotimet e ardhura nga Serbia dhe të bëjë rinumërimin e 1 472 vendvotimeve. Këto dy vendime të PZAP-it kanë ardhur pas ankesave të koalicionit Nisma-AKR-PD dhe të disa partive dhe kandidatëve për deputetë. Këtë vendim e ka përshëndetur koalicioni Nisma-AKR-PD, kurse e kanë kritikuar Lëvizja Vetëvendosje dhe Lista Serbe. Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, në një konferencë për media ka bërë me dije se me anulimin e votave nga Serbia, koalicioni Nisma-AKR-PD ka kaluar pragun zgjedhor. Ai ka thënë se PZAP-i me këtë vendim tregoi se është gardian i mbrojtjes së demokracisë

KQZ-ja më 7 nëntor. Këtu kam parasysh dy vendimet që kanë të bëjnë me përfundimtar nga rezultati të një pjesë të fletëvotimeve dhe për rinumërimin e 1 472 vendvotimeve. Në këto vendime ka këshillë juridike që lejon ankesën kundër këtyre vendimeve në Gjykatën Supreme. Prandaj, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është i obliguar ta respektojë këtë afat ligjor para se të procedojë më tutje. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të veprojë ashtu siç ka bërë deri më tani, pra në përputhje me vendimet që e obligojnë KQZ-në", ka thënë zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi.

Limaj: PZAP-i, gardian i mbrojtjes së demokracisë

Kosovë ka burra e gra me integritet profesional që shtetin ligjor e kanë të shenjtë. PZAP sot u ka bërë një shërbim të madh proceseve demokratike në Kosovë, duke kthyer deri në një masë integritetin e zgjedhjeve", ka deklaruar Limaj, duke shtuar se PZAP ka intervenuar për ta kthyer rezultatin e rregullt ashtu siç kanë votuar qytetarët e Kosovës. "Me rezultate të rregullta Nisma dhe partnerët janë parti parlamentare dhe ne do të vazhdojmë fuqishëm aktivitetin tonë politik parlamentar. Shpreh mirënjohjen time për të gjithë ata publicistë e gazetarë të cilët tejkaluan dhe nuk e shikuan këtë betejë si betejë të një subjekti për ligjshmëri, por e panë më të drejtë se ishte luftë për kthimin e ligjshmërisë në vend. Ata e panë se nëse pranohen si të rregullta ato kuti kontrabande, po cenohet integriteti i zgjedhjeve", ka deklaruar ai.

Vendimin e PZAP-së e ka përshëndetur edhe drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, i cili ka thënë se me këtë vendim paneli ka ruajtur integritetin zgjedhor të zgjedhjeve të 6 tetorit. "PZAP-i me vendimet e veta ka garantuar integritetin zgjedhor, transparencën e nevojshme, votimin e lirë dhe numërimin e secilës votë në mënyrë të drejtë. Vendimet e PZAP-së garantojnë standardet universale për zgjedhje të drejta dhe të lira. Këto standarde janë shumë më të rëndësishme se secili rezultat që mund të dalë në zgjedhje, më të rëndësishme se koha dhe procedurat për t'u zbatuar", ka thënë Kryeziu.

LV-ja dhe Lista Serbe kritikojnë vendim e PZAP-it

Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, e ka quajtur joserioz dhe të ndikuar Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i cili ka marrë vendim për numërimin e 1 472 vendvotimeve. Në profilin e vet në "Facebook", ajo ka shkruar se ky panel po tallet duke dërguar rreth 1 500 kuti në rinumërim.

"Me zgjedhjet më të mira të organizuara ndonjëherë, PZAP-i ka gjetur të tallet duke dërguar rreth 1 500 kuti në rinumërim. Institucion joserioz dhe duket i ndikuar, fatkeqësisht. Kot e kanë, fitoren e Lëvizjes nuk e ndalin dot, vullnetin e popullit nuk mund ta përmbysin, ndonëse tentojnë ta vonojnë jetësimin e tij", ka shkruar Haxhiu.

Kurse Lista Serbe në reagimin e vet ka vlerësuar se refuzimi i votave nga Serbia është një farsë shoviniste. "Rezultati i llogaritjeve politike, pjesë e të cilave është një 'farsë shoviniste' me numërimin e votave të serbëve të zhvendosur me disa skafandra, tregoi se çfarë kishte për synim të tregojë në fund me miratimin e vendimit të Panelit të Zgjedhjeve për t'i refuzuar të gjitha votat e serbëve të zhvendosur", është thënë në reagimin e Listës Serbe, duke shtuar se një vendim i tillë është i motivuar politikisht.

LV-së i hiqen tre deputetë, LDK-së, PDK-së dhe AAK-së nga një

Nëse vendimi i PZAP-it mbetet përfundimtar dhe rinumërimi i 1 472 vendvotimeve nuk sjellë ndryshim në rezultat, koalicioni NISMA-AKR-PD do të përfaqësohet në Kuvend me këta deputetë: Fatmir Limaj, Behgjet Pacolli, Endrit Shala, Haxhi Shala, Mirlinda Sopi-Krasniqi dhe Albulena Balaj. Ndërsa Albert Krasniqi, njohës i proceseve politike në vend, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se, në krahasim me rezultatet e shpallura, LV-ja do të ketë tre deputetë më pak, LDK-ja do të ketë një deputet më pak, PDK-ja do të ketë një deputet më pak dhe AAK-PSD do të ketë një deputet më pak.

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka aprovuar të hënën ankesën e koalicionit Nisma-AKR-PD për largimin nga rezultati përfundimtar të zgjedhjeve të 6 tetorit të votave nga Serbia. Po ashtu, ky panel ka marrë vendim edhe për rinumërim të 1 472 vendvotimeve. "PZAP-i 53 ankesa i ka pranuar të bazuara. Prej tyre, lidhur me 52 ankesa, paneli ka vendosur që ta urdhërojë KQZ-në për rinumërimin e 1 472 vendvotimeve. Ndërsa lidhur me ankesën e parashtruar nga Koalicioni Nisma - Aleanca

Kosova e Re - Partia e Drejtësisë, ka urdhëruar KQZ-në që t'i largojë nga rezultati përfundimtar i zgjedhjeve votat e votuesve jashtë Kosovës, të ardhura nga Serbia", është thënë në njoftimin e PZAP-it.

Zyrtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kanë bërë me dije se kanë pranuar vendimet e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) duke treguar se do t'i respektojë të gjitha procedurat ligjore. "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka pranuar vendimet e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa lidhur me ankesat e paraqitura në këtë institucion në rezultatet përfundimtare të shpallura nga

Vendimi i PZAP-it ka nxitur reagime të partive që kanë bërë ankesa në këtë institucion dhe shoqërisë civile. Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka bërë me dije se me anulimin e votave nga Serbia, koalicioni Nisma-AKR-PD ka kaluar pragun zgjedhor. Në një konferencë për media ka thënë se vendimi i PZAP-it ka treguar se ka institucione që e respektojnë ligjin. "Vendimi i PZAP tregon se në Kosovë ka institucione që mbrojnë ligjin. Shteti ligjor mbrohet çdo ditë me vepër. Çdo anëtar i PZAP-së duhet të ndihet krenar që në vete ka avancuar këtë shtet ligjor dhe ka mbrojtur shtetin ligjor. Sot ai organ u tregoi të gjithëve se po në

MPJ e cilëson të rremë lajmin për tërheqjen e njohjes së Kosovës nga Gana

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Ministria e Jashtme e Kosovës e cilëson gënjeshtër lajmin për tërheqjen e njohjes së Kosovës nga Gana. Jetlir Zyberaj, këshilltar i ministrit të Jashtëm në largim të Kosovës, Behgjet Pacolli, ka thënë se ky është një tjetër lajm i rremë. "Çdo anëtar i Kombeve të Bashkuara mbështet dialogun midis Kosovës dhe Serbisë.

Shumica e vendeve anëtare të OKB-së kanë votuar në vitin 2010, rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme që të fillojë dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", ka thënë Zyberaj për "Radion Evropa e Lirë".

Lajmin për, siç është thënë, tërheqjen e vendimit për njohjen e Kosovës nga shteti i Ganës, e ka prezantuar ministri i Jashtëm i

Serbisë, Ivica Dačić. "Është një propagandë e vazhdueshme dhe një fushatë e ndyrë nga Ivica Dačić dhe është e kotë të humbësh kohë me të", ka thënë Zyberaj.

Dačić, në anën tjetër, u ka thënë mediave në Beograd se Gana është shteti i 16 që ka tërhequr njohjen ndaj pavarësisë së Kosovës.

Në vitin 2018, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, pranoi letrat kredenciale nga ambasadorja, Selma Frances Mancell, e cila është ambasadore jorezidente e Ganas në Kosovë, meqë është e vendosur në Turqi. Më 23 janar 2012 Gana e njohu Kosovën shtet të pavarur. Të njëjtin vit të dy vendet vendosën edhe marrëdhënie diplomatike.



Ideja e Shengenit Ballkanik ka ngjallur reagime të shumta në Kosovë dhe më gjerë

Kosova kundër minishengenit



Njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të integrimeve evropiane e kanë kundërshtuar nismën e Shengenit Ballkanik. Blerim Reka, Lisen Bashkurti, Sabri Kiçmari dhe Vigan Qorrolli kanë vlerësuar se kjo iniciativë rajonale është e dëmshme për Republikën e Kosovës dhe duhet të refuzohet. Sipas tyre, pas kësaj nisme fshihen shumë të panjohura që nuk e marrin për bazë realitetin politik të Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran. "Është një lëvizje emocionale dhe jo e menduar mirë në rrafshin strategjik. Është një lëvizje ndarëse ballkanike. As minishengeni dhe as euroskepticizmi populist nuk janë zgjidhje. Orientime strategjike kombëtare të shqiptarëve janë Evropa dhe Perëndimi", ka thënë ish-ambasadori Kiçmari

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Nisma e Shengenit Ballkanik është pritur me shumë shqetësim në Kosovë. Madje kjo nismë rajonale është kundërshtuar fuqishëm nga zyrtarët shtetërorë të Kosovës dhe njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të integrimeve evropiane, duke u cilësuar si e dëmshme për Republikën e Kosovës. Sipas tyre, kjo iniciativë është e prirë të dështojë sikurse iniciativat e mëparshme. Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Blerim Reka, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar

se pas kësaj iniciative fshihet Unioni Ballkanik. Sipas tij, kjo është Jugosfer 2.0. "Jugosfera 2.0. ra perdja edhe e trelaterales së Ohrit. Aty pranë Shën Naumit, të cilin Zogu ia dhuroi Pashiqit, krijuesit të Partisë Radikale Serbe, kryetar i së cilës sot është Vuçiqi. Ky, i vetëdijshëm që sot nuk ka as Zog që pranon union nën kurorën e karagjorgjeviqëve e as hoxhë, për Shqipërinë, si Republikë të Shtatë të Titos, propozon tash Union Ballkanik. Por, nën hegjemoninë e Beogradit. Për hair Jugosfera 2.0!", ka shkruar Reka. Edhe profesori tjetër i marrëdhënieve ndërkombëtare, Lisen Bashkurti, e ka kundërshtuar këtë iniciativë. Sipas tij, kjo

nismë është ideuar dhe lansuar pa konsideruar aspak realitetin politik të Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran. "Shigjetimet e Kosovës, politikës, medias dhe opinionit publik të saj drejtohen kryesisht kundër qeverisë Rama. Anashkalimi i Kosovës, moskonsultimi paraprak me të, bërja e qëndrimeve zyrtare 'fact accompli' janë të papranueshme në marrëdhëniet ndërshtetërore në kohën tonë. Kur ky anashkalim, ose më drejtpërdrejt ky injorim i shtetit të Kosovës vjen nga qeveria Rama, kjo përbën një shkelje të rëndë të marrëdhënieve strategjike Shqipëri - Kosovë, një dëmtim serioz të raporteve speciale Tiranë - Prishtinë, një cenim të balancave shumë

delikate ballkanike në proceset e nisura për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësim ndërkombëtar, një përpjekje për t'u imponuar brutalisht mbi politikën shtetërore të aplikuara nga Kosova ndaj Serbisë për reciprocitet", ka vlerësuar Bashkurti. Sipas tij, deklarata e kryeministrit Rama në Ohër, se Kosova është vetëpërgjegjëse nga kjo iniciativë, është e pavërtetë, e paarsyeshme dhe e padobishme për Kosovën për marrëdhëniet speciale Shqipëri

Ballkanike ku bën pjesë edhe Serbia, siç është edhe nisma e Shengenit Ballkanik, e kthen Kosovën në statusin e përpara 1999-s.

Ndërsa njohësi i integriteteve evropiane, Vigan Qorrolli, ka bërë me dije se kjo iniciativë është e destinuar që të dështojë. "Ballkani prej se ekziston ka funksionuar me mosbesim të thellë mes popujve dhe shteteve të tij, që prej dy luftërave ballkanike, deri në shpërbërjen e përgjakshme të ish-Jugosllavisë. Shihen Bosnjën si funksionon sot: shteti me rregullimin më të çoroditur konstitucional dhe politik në botë. Kështu që mos kini merak, edhe kjo iniciativa për Shengenin Ballkanik do të dështojë, siç ka dështuar instrumenti kryesor ekonomik i BE-së i krijuar për vetë Ballkanin, i quajtur CEFTA", ka shkruar Qorrolli në profilin e vet në "Facebook".

Minishengenin Ballkanik e ka komentuar edhe ish-ambasadori i Kosovës në Austri dhe Australi, Sabri Kijçmari, i cili ka thënë se kjo iniciativë është ndërmarrë në një situatë zhgënjimi të kryeministrit shqiptar Edi Rama dhe atij maqedonas Zoran Zaiev, pas moshapjes së negociatave për anëtarësim me BE-në. "Është një lëvizje emocionale dhe jo e menduar mirë në rrafshin strategjik. Është një lëvizje tipike ndarëse ballkanike. Dëshpërimi në raste të tilla nuk duhet të jetë motivi lëvizës vendimmarrës. Shqipëria dhe Kosova nuk duhet të shkojnë ndaras në projekte rajonale. Është interes strategjik maksimalizimi i fuqisë ndikuese në rajon", ka thënë ai, duke shtuar se kjo gjë mund të bëhet vetëm përmes një koordinimi dhe hapërimi të menduar mirë. "As minishengeni dhe as euroskepticismi populist nuk janë zgjidhje. Orientime strategjike kombëtare të shqiptarëve janë Evropa dhe Perëndimi. Rikthimi te idetë për një strukturë të re integruese ndërballkanike është shmangie prej të dëshpëruari nga orientimi strategjik evropian. Për ta përsheptuar procesin e integritetit në BE dhe NATO Shqipëria dhe Kosova duhet të kenë momente serioze të reflektimit diplomatik, duke vënë në zbatim artin e negociimit dhe diplomacinë me sens dhe durim", është shprehur Kijçmari. Kurse presidenti Hashim Thaçi, i cili ka refuzuar pjesëmarrjen në Samitin e Ohrit, që ishte në shërbim të kësaj nisme, ka thënë kjo iniciativë rajonale është e pakuptimtë për aq kohë sa Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina nuk e njohin pavarësinë e Kosovës.

Përpjekja për Shengen Ballkanik është iniciuar kohë më parë nga Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria në Novi Sad. Kjo vijoi këtë fundjavë në Ohër të Maqedonisë së Veriut. Këto tri vende janë pajtuar që takimi i radhës i këtij samiti të mbahet në muajin dhjetor, në Durrës.

Studentëve të arsimit privat u mundësohet praktika në ShSKUK

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka miratuar rregulloren për përcaktimin e kushteve dhe organizimin e praktikës klinike dhe ushtrimeve për studentët të institucioneve private të arsimit të lartë. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i formës dhe procedurës së realizimit të praktikës klinike dhe ushtrimeve në njësitë përbërëse të ShSKUK-së për institucionet private të arsimit të lartë.

Rregullorja mundëson që Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës ta sigurojë realizimin e praktikës klinike dhe ushtrimeve për të gjithë studentët e institucioneve private të arsimit të lartë, të licencuara dhe akredituara sipas legjislacionit në fuqi. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, në bashkëpunim me drejtorin për Arsim dhe Shkencë, caktojnë personin përgjegjës për koordinimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të praktikës klinike dhe ushtrimeve.

Mentorët klinikë, që angazhohen në pajtim me këtë rregullore, duhet të jenë në marrëdhënie pune në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës. Institucioni privat i arsimit të

lartë ka obligim ta paguajë secilin mentor klinik në përputhje me orët e angazhimit. Praktika klinike dhe ushtrimet në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar organizohen pas përfundimit të orarit të rregullt të punës në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (07:00-15:00).

Praktika klinike dhe ushtrimet për studentët e institucioneve private të arsimit të lartë në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës organizohet me pagesë. PAGESA realizohet si kompensim për shërbimet profesionale të marra në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës dhe për mentorim.

Për studentët e drejtimit Infermieri, Mami, Fizioterapi, Logopedi, Laborantë, Psikologji dhe Radiologji, të cilët kryejnë praktikë klinike në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Institucioni Privat i Arsimit të lartë duhet t'i paguajë shumën prej njëqind e pesëdhjetë (150) eurosh për një (1) student për një (1) vit akademik. Studentët e drejtimit Stomatologji, të cilët kryejnë ushtrime dhe praktikë në ShSKUK, institucioni privat i arsimit të lartë duhet t'i paguajë një mijë e pesëqind (1 500) euro për një (1) student për një (1) vit akademik.

Studentët e drejtimit farmaci,

që kryejnë ushtrime dhe praktikë në ShSKUK, institucioni privat i arsimit të lartë duhet t'i paguajë ShSKUK-së shumën prej katërqind (400) eurosh për një (1) student për një (1) vit akademik.

Kjo rregullore ka hyrë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas miratimit nga ana e Bordit Drejtues të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës.

Në bazë të dispozitave të Rregullores së brendshme për realizimin e praktikës klinike dhe ushtrimeve në ShSKUK, nuk kërkohet pagesë nga studentët e institucioneve private të arsimit të lartë për mbajtjen e praktikës apo ushtrimeve.

ShSKUK kërkon pagesën nga Institucioni Privat i Arsimit të lartë si kompensim për shpenzimet e krijuara gjatë realizimit të praktikës dhe ushtrimeve, kërkon pagesën për mentorët klinikë sipas angazhimit të tyre dhe në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Dispozitat e rregullores së miratuar sqarojnë se bashkëpunimi i institucioneve të arsimit të lartë me ShSKUK-në i takon krejtësisht vullnetit të lirë të palëve.

Deri tani marrëveshjet për pjesën praktike janë realizuar individualisht në marrëveshje ndërmjet institucionit privat të akredituar dhe ShSKUK-së.



-Kosovë. "Kosova nuk u vetizolua, por u vetëmbrojt. Dhe bëri shumë mirë. Shumë drejt. Shumë saktë. Bëri të vetmen gjë që duhej dhe mund të bënte. Kosova ka një problem madhor. Ky është njohja e pavarësisë, tërësisë territoriale dhe sovranitetit të saj nga Serbia. Kosova nuk mund dhe nuk duhet të marrë pjesë në asnjë iniciativë integruese politike rajonale ku bën pjesë Serbia, pa normalizuar më parë marrëdhëniet me të, pa u njohur si shtet i pavarur, sovran dhe me integritet territorial të pacenueshëm nga Serbia", është shprehur ai, duke shtuar se çdo pjesëmarrje e Kosovës në procese integruese

Kushtet ekonomike dhe migrimi, ndër faktorët që ulën natalitetin në Kosovë



Reuters

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Nataliteti në Kosovë po shënon rënie nga viti në vit. Planifikimi familjar, kushtet e rënda ekonomike, edhe ikja e të rinjve jashtë vendit, janë disa prej arsyeve që potencohet se kanë ndikuar në rënien e natalitetit.

Gyltene Kolloviçi është nënë e re e cila sapo ka lindur fëmijën e dytë. Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ajo thotë se nuk planifikon të lindë më fëmijë për disa arsye. "Është lindja ime e dytë, është vajzë, kurse të parin e kam djalë. Unë nuk planifikoj të lind më shumë fëmijë. Besoj mjaftojnë vajzë dhe djalë. Nuk planifikoj për shkak se kushtet ekonomike nuk i kemi aq të mira sa të lind më shumë fëmijë, por edhe trupi ynë mendoj nuk duron më shumë sepse është sfidë", ka thënë Kolloviçi.

Nataliteti në rënie në Kosovë është dukuri në vitet e fundit, pasi gjatë

viteve '80 dhe '90, Kosova ishte ndër vendet me shtimin më të madh të popullsisë në ish-Jugosllavi. Për gjeneratat më të vjetra, rënia e lindshmërisë nuk është një dukuri pozitive. Fevzi Mahmuti, 69-vjeçar nga Prishtina, thotë se i ka pesë fëmijë. Por, fëmijët e tij, thekson ai, i kanë vetëm nga një ose dy fëmijë. Ai thotë se do të dëshironte të shihte më shumë nipa e mbesa rreth tij. "Besoj se nataliteti në Kosova ka rënë shkak i kushteve të vështira ekonomike. Më shumë se një fëmijë ose dy, të rinjtë nuk po i bëjnë. Shumë keq. Mendoj se duhet të kenë më shumë fëmijë. Unë për vete i kam pesë fëmijë. Djali im i ka dy dhe nuk mendon të ketë më fëmijë tjetër. Vajza e ka vetëm një", ka thënë Mahmuti.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, numri i lindjeve të gjalla të ndodhura brenda Kosovës për

vitin 2014 ishte 25 929. Në vitin 2015 në gjithë Kosovën kishin lindur 24 594 foshnje. Ndërkaq në vitin 2016 kanë qenë 23 416 foshnja të lindura, derisa në vitin 2017 kanë lindur 24 402 foshnje. Viti 2018 është përmbyllur me 22 761 foshnje të lindura të gjalla.

Drejtori i Klinikës Gjinekologjike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, Jakup Ismaili, thotë se, nëse krahasohet vetëm nëntëmujori i parë i këtij viti me atë të vitit të kaluar, rezulton se vetëm në institucionin që ai udhëheq kanë lindur 400 foshnja më pak. "Për nëntëmujorin e parë të këtij viti kanë qenë 7 256 lindje. Nëse krahasohet me nëntëmujorin e vitit të kaluar, janë rreth 400 lindje më pak. Në vitin 2014 kemi 10 307 lindje, 2015 kemi 9 443 lindje, në vitin 2016 kemi 10 139 lindje, në vitin 2017 janë 10 161 lindje dhe në vitin 2018 janë 9 963 lindje.

Ndër vite ka rënie, por nuk është rënie shqetësuese. Por, lindjet e tjera sigurisht kryhen në spitale regjionale, pra këto janë lindjet vetëm në QKUK. Dy vjetët e fundit, nëse bëhet krahasimi, 400 lindje më pak. Arsyet që ne po i shohim këtu janë planifikimi i familjes në bazë të kushteve ekonomike, por edhe një numër i madh i të rinjve po dalin jashtë vendit", ka thënë Ismaili.

Ndërkaq, sociologët thonë se do të duhej që institucionet gjegjëse të zhvillojnë strategji që ta promovojnë rëndësinë e natalitetit.

Besnik Peci, sociolog, thotë për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se trendi i migrimit dhe trendi i ulët i natalitetit, Kosovën pas 20 vjetësh do ta gjejë me popullatë shumë modeste në Ballkan. "Rënia e natalitetit në Kosovë i atribuohet mungesës së një strategjie të qartë kombëtare për ta promovuar

qartë zhvillimin dhe shtimin e natalitetit. Për dallim nga të gjitha vendet e rajonit, që i kanë zhvilluar strategjitë e tyre për ta mbështetur natalitetin përmes fuqizimit ekonomik të familjeve, te ne nuk ka asnjë veprim konkret që do ta ndihmonte këtë proces. Pastaj kjo lidhet edhe me varfërinë, pavarësisht se në të kaluarën kur gjendja e tyre ekonomike ishte e vështirë, kanë lindur më shumë fëmijë, pas luftës ekziston një rritje e vetëdijes dhe sigurimi i mbijetesës është më i lartë", ka thënë Peci.

Sidoqoftë, sipas zyrtarëve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë në Kosovë, për rënien e natalitetit nuk janë bërë studime por, siç kanë thënë ata, mund të supozohet se trendi i uljes së natalitetit prek secilin vend në zhvillim, e në këtë rast po e prek edhe Kosovën.

Nga 25 nëntori fillon furnizimi me targa

PRISHTINË, 11 NËNTOR (ER) - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka njoftuar se është shpallur kompania fituese për furnizim me targa. "Pas përfundimit të të gjitha procedurave

që kërkohen, pas nënshkrimit të kontratës që do të bëhet më datë 19.11.2019, qytetarët nga data 25 nëntor mund të drejtohen te Qendrat për Regjistrim të Automjeteve, në të gjitha komu-

nat e Kosovës, që të pajisen me targa", thuhet në njoftimin e MPB-së.

MPB-ja u kërkon falje të gjithë qytetarëve që nuk ka mundur t'i furnizojë me targa.



Minatorët e "Trepçës" nisin grevën

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Minatorët e Kombinatit Metalurgjik "Trepça" kanë bojkotuar të hënën punën, duke filluar kështu grevën për shkak të pagave të cilat nuk i kanë marrë për muajin tetor dhe një pjesë e pagave nuk u është dhënë për muajin shta-

tor. Kështu ka thënë për gazetën "Epoka e re" Gani Osmani nga Sindikata e Punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje. "Të hënën ndërimi i parë i punëtorëve nuk e ka filluar punën dhe minatorët kanë hyrë në grevë. Pagat duhet të paguhen sepse sot është data

11 nëntor dhe ende s'kemi marrë pagën. Po ashtu, minatorët nuk kanë marrë një përqindje të pagave edhe të muajit shtator", ka thënë Osmani, duke shtuar se greva do të vazhdojë deri në plotësimin e kushteve të kërkuara. (A. MAVRAJ)



Çmimet e konsumit shënuan rritje për 2.2 për qind

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit" (IHÇK) për muajin tetor të vitit 2019, viti bazë 2015=100. Sipas ASK-së, inflacioni mujor i matur nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte i pandryshuar 0.0 për qind në muajin tetor 2019 krahasuar me muajin shtator 2019. "Përkundër mosndryshimit në muajin tetor 2018 të Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit, krahasuar me muajin shtator 2019, vërehen

disa ndryshime të çmimeve të artikujve dhe shërbimeve të grupet dhe nëngrupet e COICOP-it. Ngritje e çmimeve vërehet te këto nëngrupe: perime (0.6 për qind); ujë, pije joalkoolike, lëngje nga pemët dhe perimet (0.7 për qind); energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera (0.8 për qind) (ngritje e çmimit të drunjve për ngrohje); blerje e automjeteve (2.3 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0.3 përqindësh në IHÇK", është thënë në raportin e ASK-së, duke shtuar se ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve të nëngrupet e COICOP-it: qumësht, djathë dhe vezë (-1.1 për qind); pemë

(-7.4 për qind); shërbimet për transport (-2.4 për qind) (rënie e çmimeve të biletave të transportit ajror), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0.3 për qind) në IHÇK. "Shkalla vjetore e inflacionit e matur në muajin tetor 2019 me muajin tetor 2018 ishte 2.2 për qind. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të nëngrupet e COICOP-it: bukë dhe drithëra (11.8 për qind); mish (2.0 për qind); qumësht, djathë dhe vezë (1.6 për qind); vajra dhe yndyra (3.1 për qind); pemë (3.8 për qind); sheqer, reçel, mjaltë, çokolatë dhe ëmbëlsira (2.7 për qind); kafe, çaj dhe

kakao (10.3 për qind); ujë, pije joalkoolike, lëngje nga pemët dhe perimet (1.0 për qind); duhan (2.7 për qind); energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera (0.9 për qind) (ngritje e çmimeve të drunjve për ngrohje), mobilie, qilima dhe mbulesa dyshemeje të tjera (1.2 për qind); pajisje shtëpiake (1.6 për qind); qelqurina, takëme dhe mjete të kuzhinës (4.4 për qind); mallra dhe shërbime për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (2.9 për qind); shërbime ambulatore (1.7 për qind); blerje e automjeteve (3.7 për qind); shërbime telefonike dhe të telefaksit (0.9 për qind); shërbime për strehim (4.6 për qind); gjëra

personale (3.7 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 2.5 për qind në IHÇK", thuhet në raportin e ASK-së.

Sipas ASK-së, ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOP-it: perime (-4.5 për qind); përdorim i pajisjeve për transportin personal (-1.4 për qind) (rënie e çmimit të naftës dhe benzinës); shërbime për transport (-3.3 për qind) (rënie e çmimeve të biletave të transportit ajror); pajisje audio-vizuale, fotografike për përpunimin e informatave (-3.1 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0.3 për qind) në IHÇK.



ATK-ja grumbulloi 432.3 milionë euro

PRISHTINË, 11 NËNTOR (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) nëpërmjet një njoftimi për media ka bërë me dije se vazhdon të ketë përparim në mbledhjen e të hyrave edhe për periudhën janar - tetor 2019, duke grumbulluar 432.3 milionë euro tatime, ku në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ka rritje

për 10.4 për qind apo 40.6 milionë euro më shumë. "Rezultat i kësaj performance është rritja e përmbushjes vullnetare, ofrimi i shërbimeve profesionale dhe transparente ndaj tatimpaguesve, rritja e komunikimit me tatimpagues, si dhe shtimi i aktiviteteve të tjera në terren. Po ashtu, këtu rol të rëndësishëm ka edhe

pjesa e legjislacionit tatimor, përmes së cilës bëhen përpjekje të vazhdueshme që të krijohet një infrastrukturë e mirë ligjore. Menaxhmenti i ATK-së me përkushtim do të vazhdojë t'i zbatojë të gjitha dispozitat ligjore në mënyrë që secili tatimpagues ta deklarojë drejt pjesën që i takon me ligj", është thënë në njoftimin e ATK-së.



EKSPERTIZA ZVICERANE ZHVESH FSHEHJEN E KRIMIT PËR RASTIN 'ASTRIT DEHARI'

**Shkruan: Bardhyl
MAHMUTI**

Si rezultat i hulumtimeve të tyre, ekspertët zviceranë erdhën në përfundim se Astrit Dehari jo vetëm që nuk ka bërë vetëvrasje, por objektivisht as që e ka pasur të mundur të bënte vetëvrasje me sendet dhe me mënyrën që kanë përshkruar institucionet e Kosovës, të përfshira në rastin "Astrit Dehari". Rrjedhimisht, vdekja e dhunshme e Astrit Deharit është vrasje. Mënyrat dhe mjetet që janë përdorur gjatë kësaj vrasjeje nuk kanë mundur të jenë rezultat i një personi të vetëm. Prandaj një hetim i drejtë i këtij krimi duhet ta nxjerrë në shesh të vërtetën rreth asaj se sa persona u përfshinë në vrasjen e Astrit Deharit.

Siç u përmend në shkrimin paraprak, ekipi mjeko-ligjor i Kosovës përpiloi diagnozën e vdekjes së Astrit Deharit "si pasojë e asfiksionit mekanike nga bllokimi i rrugëve të sipërme të frymëmarrjes nga një mjet me konsistencë solide (i fortë) dhe se shaktimi i vdekjes mund të shpjegohet me ndaljen e menjëhershme të punës së zemrës" (në tekstin e autopsisë: ndaljen "reflektore të punës së zemrës"). Ndërsa nga të gjitha lëndimet që shiheshin në trupin e Astrit Deharit, ata zgjodhën t'i përmendin vetëm lëndimet në anën e djathtë të qafës dhe në pjesën e poshtme të brendshme të parakrahut të dorës së majtë dhe i përkufizuan

si "dëmtime (gërvishtje) sipërfaqësore të lëkurës të vetëshkaktuara". Konstatimet e lartpërmendura i dhanë mundësinë kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, Sylë Hoxha, që më datë 18 nëntor 2016 ta shpallë vdekjen e Astrit Deharit si "vetëvrasje".

Duke analizuar tërësinë e materialeve që u ishin dërguar nga Kosova dhe duke u mbështetur në literaturën shkencore, ekipi mjeko-ligjor zviceran rrëzon njëherë pas tjetrës të dyja diagnozat. Ekspertët zviceranë tërheqin vërejtjen se "raporti i autopsisë përmend ndërprerjen e menjëhershme të zemrës, të shkaktuar nga shishja e vendosur në gojë, si mekanizëm kryesor i vdekjes. Në literaturën shkencore ky mekanizëm i vdekjes njihet me emrin "bolusdeath" dhe përkufizohet si vdekje e shkaktuar nga bllokimi i laringut ose i pjesëve më të poshtme të faringut, i shoqëruar me një ndalim të menjëhershëm të punës së zemrës". Diagnoza e tillë hidhet poshtë nga ekspertët zviceranë, sepse "në këtë rast nuk do të kishim të bënim me vdekje prej asfiksionit".

Përfundimisht e vdekjes së Astrit Deharit, me një ndalim të menjëhershëm të punës së zemrës ("bolusdeath"), siç është thënë në raportin e autopsisë, ekspertët zviceranë e mbështesin në praninë e shenjave të mëposhtme të asfiksionit në trupin e Astrit Deharit, që konsiderohen shenja "klasike" të asfiksionit: "Petekiet (njolla të kuqe në



vjollcë) në cipat e holla të sipërme dhe të poshtme të kokërdhokut të syrit të majtë; në cipën e hollë të poshtme të qepallës së djathtë dhe në cipën e hollë të sipërme të qepallës së majtë, në cipat e holla të sipërme të të dyja qepallave dhe në cipën e hollë të sipërme të kokërdhokut të djathtë, zgjerimi i enëve të gjakut dhe edema në mushkëri (që u shpreh gjatë autopsisë me derdhje gjaku nga zgavrat e hundës dhe nga goja)".

Fakti i dytë ku mbështeten ekspertët zviceranë për ta rrëzuar diagnozën e ndalimit të menjëhershëm të punës së zemrës së Astrit Deharit ka të bëjë me mbylljen e rrugëve të frymëmarrjes. Sipas raportit të autopsisë, "shishja ka mbyllur zgavrën e gojës në thellësi", ndërkaq ekspertët zviceranë pohojnë se baza e shishes plastike (me diametër 6 cm) ka qenë mbi epiglotë (epiglota është një strukturë kërcore anatomike në rrënjën e gjuhës, që mundëson ndarjen e faringut dhe të laringut gjatë gjëllitjes) dhe, rrjedhimisht, nuk ka mundur ta bëjë bllokimin e laringut ose të pjesëve të poshtme të faringut. Konstatimi i pranishëm së madhe të materieve ushqimore në bronke dhe mushkëri është argument ku mbështeten ekspertët zviceranë

sepse, "që të ndodhë një bronkoaspiracion i tillë, është e nevojshme që hapësira ndërmjet mureve të laringut të jetë e lirë". Fakti i tretë ku mbështeten ekspertët zviceranë për ta rrëzuar diagnozën e ndalimit të men-

jëhershëm të punës së zemrës së Astrit Deharit ka të bëjë me konstatimet se kur i është tërhequr shishja nga goja, Astrit Dehari ka pasur puls dhe ka marrë frymë. Kjo vërtetohet në bazë të dëshmiave të gardianit të burgut, Daut Kastrati, i cili pohoi se, "kur i ka tërhequr shishen nga goja, Astrit Dehari ende kishte puls, lëvizte dhe se ajri dilte nga goja e tij" (procesverbalet e datës 5 nëntor 2016). Të njëjtën gjë pohoi edhe Bukurie Kodraliu, infermierja e Qendrës së Paraburgimit në Prizren (anëtarja e parë e personelit mjekësor që e ka ekzaminuar Astrit Deharin), e cila e "ka verifikuar pulsin e Astrit Deharit në qafë dhe ka konstatuar se ai kishte puls dhe se merrte frymë" (procesverbali i datës 9 nëntor 2016).

Nga sa u tha më lart, del qartë se ekspertiza zvicerane hedh poshtë diagnozën e ekipit mjeko-ligjor të Kosovës për "ndaljen e menjëhershme të punës së zemrës si shkaktar i vdekjes së Astrit Deharit".

Pas çmontimit/zbardhjes të pretendimeve për "ndalimin e menjëhershme të zemrës", ekipi mjeko-ligjor zviceran përqendrohet në cilësimin "e asfiksionit së Astrit Deharit me shishe plastike si vetëvrasje".

Kur bëhet fjalë për zënien e frymës, ekspertët zviceranë fillimisht sqarojnë se nga pikëpamja teorike, "asfiksia përkufizohet si ndërprerje e furnizimit, e mbartjes së oksigjenit drejt organeve të trupit dhe e shfrytëzimit të tij. Truri është organi më i ndjeshëm

në situatat kur kemi mungesë të oksigjenit. Ai është organi i parë që preket nga mungesa e oksigjenit". (Në raportin jepen referencat bibliografike për të gjitha përkufizimet, të cilat nuk do t'i citoj, që të mos e ngarkoj shkrimin. Lëxuesit e interesuar për burimin e këtyre përkufizimeve mund t'i gjejnë në raportin e publikuar në internet).

Në grupin e parë, nga katër grupet e asfiksionit që përmend ekipi mjeko-ligjor zviceran, hyn "zënia e frymës e llojit 'smothering', që ka të bëjë me bllokimin të rrugëve të frymëmarrjes mbi epiglotë".

Siç e pamë në shkrimin paraprak, sajuesit e interpretimit të rastit "Astrit Dehari" u përpoqën ta prezantojnë sikur gjoja Astrit Dehari fillimisht kishte tentuar t'i shkaktonte vetes lëndime me brisk rroje dhe pastaj kishte zbatuar metodën e zënies së frymës të llojit "smothering". Interpretimet e tilla hidhen poshtë nga ekspertët zviceranë për dy arsye thelbësore:

Së pari, "në literaturën shkencore asnjëherë nuk është përshkruar vetëvrasja komplekse, që përfshin një zënie fryme të llojit 'smothering', të cilit t'i ketë paraprirë përdorimi i një sendi të mprehtë" dhe, së dyti, "vetëvrasjet komplekse karakterizojnë individë me sëmundje psikiatrike, siç janë çrregullimet e personalitetit, depresioni ose skizofrenia. Ndërkaq, z. Astrit Dehari nuk paraqiste asnjë problem psikiatrik dhe as shenja të depresionit". Përkundrazi, në bazë të "raportit për gjendjen psikologjike të të



paraburgosurit Astrit Dehari", të datës 6 shtator 2016, dhe procesverbaleve të hetuesisë, të gjithë të intervistuarit dëshmojnë se Astrit Dehari ishte person të cilin e karakterizonte "një gjendje psikologjike e mirë dhe e qëndrueshme", "ishte njeri me vullnet të mirë", "person që nuk ka pasur dhe nuk kishte probleme psikiatrike", "person që nuk ka pasur mendime ose përpjekje për vetëvrasje"...

Sa i përket mekanizmit të asfiksionit, në rastin e z. Astrit Dehari kemi të bëjmë saktësisht me një mekanizëm të zënies së frymës të llojit "smothering" me një send me përbërje të fortë (një shishe plastike, baza e së cilës ishte me diametër 6 cm).

Analiza që bëjnë ekspertët zviceranë dëshmon në mënyrë të pakontestueshme, se edhe në hipotezën më ekstreme, në rastin nëse Astrit Dehari do të kishte dashur të bënte vetëvrasje, ai nuk do të kishte mundur t'ia zinte frymën vetes, në mënyrën si e kanë shpjeguar ekspertët e Kosovës.

Një vetëvrasje e tillë praktikisht nuk është e mundur, sepse kur ndërpritet furnizimi i organizmit me oksigjen, kemi "zvogëlimin ose ndërprerjen e tërësishme të ardhjes së gjakut të pasur me oksigjen në tru dhe kjo shkakton humbje të vetëdijes dhe të tonusit muskular (tensionit të lehtë muskular, që mundëson funksionimin e tyre edhe në gjendje qetësie). Humbja e tonusit muskular e bën të pamundur që t'i zihet fryma

vetes duke mbajtur një send në rrugët e frymëmarrjes. Nëse shishja është prej plastike, me skaje të lëmuara, e rrumbullakët dhe pa kënde, ajo nuk do të kishte qenë në gjendje të qëndronte e bllokuar në faring në atë mënyrë, që të mund ta pengonte tërësisht frymëmarrjen".

Në aspektin teorik, një vetëvrasje me mjete të tilla do të kishte mundur të ndodhte vetëm në një skenar të imagjinuar: "Në rast se viktimë shtrihet në bark dhe në kohën kur e humb vetëdijen, shishja mbetet e bllokuar në mes të kokës dhe tokës dhe, në mënyrë efikase, vazhdon t'i mbyllë rrugët e frymëmarrjes. Mundësia e realizimit të një skenari të tillë nuk pranohet nga autorët që citohen. Bëhet fjalë për një mundësi pa asnjë gjasë që të ndodhë, sepse duhet të kemi parasysh, gjithashtu, se gjatë fazës së shtrëngimeve muskulore që i karakterizojnë asfiksionin, lëvizjet e trupit do ta pengonin ruajtjen e këtij pozicioni, do të bënin që shishja të rrëshqiste ose të lëvizte dhe të liroheshin rrugët e frymëmarrjes. Megjithatë, përsëri duhet të nënvizojmë se skenari i fundit për të cilin folëm nuk mund të merret parasysh në rastin e z. Dehari, sepse trupi i tij është gjetur i shtrirë horizontalisht në shpinë (dekumitusdorsal), ashtu siç është thënë nga të gjithë dëshmitarët".

Pra, sipas ekspertëve zviceranë, edhe në një hipotezë me skenar të imagjinuar, Astrit Dehari nuk ka mundur të bëjë vetëvrasje sepse trupi i tij është gjetur në një

pozitë të tillë, që përjashton mundësinë që shishja plastike të vazhdonte t'i pengonte rrugët e frymëmarrjes.

Në raportin e ekspertizës, ekipi mjeko-ligjor zviceran thekson se në literaturën shkencore që ka konsultuar, "ka hasur vetëm në dy raste të përdorimit të zënies së frymës të llojit 'smothering', si mënyrën e vetëvrasjes. Në rastin e parë kemi të bëjmë me vendosjen e ngjitësit rreth kokës, që i pengonte rrugët e frymëmarrjes, ndërsa në rastin e dytë kemi të bëjmë me futjen e një shamie hundësh dhe dorezat prej llastiku në rrugët e frymëmarrjes mbi epiglotë. Në rastin e fundit vërejmë se karakteristikë e shamisë së futur në rrugët e frymëmarrjes është ndjeshmëria ndaj lagështisë, që ka bërë të ngjitet nga mukoza dhe ta pamundësojë hapjen spontane të rrugëve të frymëmarrjes nëpërmjet rrëshqitjes së materialit të përdorur".

Të gjitha rastet e tjera të zënies së frymës të llojit "smothering", që përmenden në raportin e ekspertëve zviceranë, janë raste të vrasjeve. Për ilustrim, ata përmenden sende që janë futur në rrugët e frymëmarrjes, gjurmë që janë gjetur në këto raste e kështu me radhë, për të arritur te konkluzioni i tyre:

"Në serinë e rasteve që sjell Boghossian et al (2010), një rast bllokimi i rrugëve të frymëmarrjes ishte kryer me kravatë, ndërkaq në rastin e dytë bllokimi ishte bërë me doreza. Për më tepër, sipas boghossian et al (2010) dhe dimaio and dimaio (2001), zënia

e frymës e llojit 'smothering' më tepër është karakteristikë e vrasjeve sesa e vetëvrasjeve. Megjithatë, do të shënojmë se sipas dimaio and dimaio (2001), vrasja me zënie fryme e llojit 'smothering' është shumë e vështirë të realizohet te një i rritur me aftësi të plota".

Për lexuesit që kanë pasur mundësi t'i lexojnë shkrimet e mia paraprake lidhur me falsifikimin e raportit të ekspertizës zvicerane për rastin "Astrit Dehari", është e qartë se teksti me shkronja kapitale është hequr qëllimisht.

Pas reagimit tim lidhur me përkthimin skandaloz të raportit të ekspertizës të Njësisë Romande të Mjekësisë Forenzike të Qendrës Universitare Ramande të mjekësisë ligjore në Lozanë të Zvicrës, përkthyesi zyrtar i këtij dokumenti, Ismail Ismaili, deklaroi: "Raporti shkencor duhet të përkthehet pothuajse fjalë për fjalë. Nuk kam guxuar t'i interpretoj thëniet e ekspertëve mjeko-ligjorë".

I takon hetuesisë të ndriçojë tërësisht se kush e hoqi fjalinë thelbësore, se zënia e frymës e llojit "smothering" më shumë është karakteristikë e vrasjeve sesa e vetëvrasjeve dhe përgjegjësit për këtë falsifikim të japin llogari në përputhje me nenin 434 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sa për arsyet pse është hequr konkluzioni i literaturës shkencore rreth kësaj çështjeje, është e qartë: kanë dashur ta fshehin faktin, se zënia e frymës e llojit "smothering", viktimë e së cilës ka qenë Astrit Dehari, më tepër është karakteristikë e vrasjeve sesa e vetëvrasjeve.

Në përkthimin zyrtar në gjuhën shqipe të raportit të ekspertizës zvicerane ky konkluzion është sakatuar kështu: "Në serinë e rasteve të Boghossian et al. (2010) obstrukcioni i rrugëve ajrore ishte kryer në një rast me kravatë dhe në dy raste të tjera me doreza. Sipas Boghossian et al. (2010) dhe të DiMaio and DiMaio (2001), vrasje me ngufatje të llojit "Smothering" është shumë e vështirë mbi një të rritur, duke pasur parasysh aftësitë e tij".

Kanë hequr konkluzionin, se kjo formë e zënies së frymës është kryesisht karakteristikë e vrasjeve dhe e kanë lënë fjalinë e fundit, me shpresë se do ta tërheqin vëmendjen në faktin se "zënia e frymës e llojit 'smothering' është shumë e vështirë të realizohet te një i rritur me aftësi të plota". Por edhe ky konstatim kthehet kundër falsifikatorëve të ekspertizës zvicerane, sepse qëndrimi i lartpërmendur nënkupton se, për ta zbatuar metodën vrasare të zënies së frymës të llojit "smothering" ndaj një personi të shëndoshë, siç ka qenë Astrit Dehari, është dashur të jetë i përfshirë më shumë se një person.

Për ekipin mjeko-ligjor zviceran, zënia e frymës e llojit "smothering" është vetëm një nga mekanizmat që është përdorur në rastin "Astrit Dehari". Në mënyrë të qartë ata theksojnë: "Megjithatë, një kombinim me mekanizmat e tjerë nuk mund të përjashtohet. Në të

vërtetë, autopsia ka zbuluar praninë e lëndimeve abrazive të shkaktuara nga goditjet me mjete të forta, jo të mprehta, në pjesën e sipërme të ballit, në pjesën e poshtme të anës së djathtë të fytyrës, në pjesën e djathtë anësore të qafës, në parakrahun e djathtë dhe në shuplakën e dorës së djathtë. Këto lëndime vërtet nuk mund të shpjegohen nëpërmjet një veprimi vetëvrasës me sende të mprehta dhe me zënie fryme. Hipoteza e lëndimeve të shkaktuara nga bartja e trupit, nga tërësia e veprimeve për ta ringjallur dhe nga shtrëngimet e rastësishme, nuk e shpjegojnë tërësinë e këtyre konstatimeve dhe nuk duket plotësisht bindëse. Këto ekimoza (mavijosje) vërehen në vendet karakteristike për lëndimet që janë shkaktuar gjatë kapjeve në qafë, të llojit "çelësi i krahut" ("clé de bras" në gjuhën frënge), ose formave të tjera të dhunës në qafë. Si përfundim, hipoteza e vetëvrasjes së z. Astrit Dehari me mjetet e paraqitura nga mjekët ligjorë duket shumë pak e besueshme. Sipas mendimit tonë, për këtë arsye rrethanat e vdekjes së z. Astrit Dehari janë shumë të dyshimta për shkak të ndërhyrjes së një personi tjetër në procesin fatal".

Ekspertiza e ekipit mjeko-ligjor zviceran nxori në shesh, se vdekja e dhunshme e Astrit Dehari nuk ka qenë vetëvrasje.

Në dy raportet e ekspertizës së tyre ekspertët e ekipit mjeko-ligjor zviceran vunë theksin në lëshimet e rënda që janë bërë gjatë procesit të hetimeve, gjatë mbledhjes së provave materiale në skenën e krimin, gjatë analizave të ADN-së dhe të gjurmëve të gishtave që ka bërë Agjencia e Kosovës për Forenzikë gjatë autopsisë së trupit të Astrit Dehari në Institutin e Mjekësisë Ligjore të Kosovës, konkluzioneve të ekipit të tij mjeko-ligjor dhe përfundimeve që nxjerrë Prokuroria Themelore e Prizrenit për, gjoja, "vetëvrasjen e Astrit Dehari".

Si rezultat i hulumtimeve të tyre, ekspertët zviceranë erdhën në përfundim se Astrit Dehari jo vetëm që nuk ka bërë vetëvrasje, por objektivisht as që e ka pasur të mundur të bënte vetëvrasje me sendet dhe me mënyrën që kanë përshkruar institucionet e Kosovës, të përfshira në rastin "Astrit Dehari". Rrjedhimisht, vdekja e dhunshme e Astrit Dehari është vrasje. Mënyrat dhe mjetet që janë përdorur gjatë kësaj vrasjeje nuk kanë mundur të jenë rezultat i një personi të vetëm. Prandaj një hetim i drejtë i këtij krimi duhet ta nxjerrë në shesh të vërtetën rreth asaj se sa persona u përfshinë në vrasjen e Astrit Dehari.

Është obligim qytetar i çdokujt që ka mundësi të ndihmojë në ndriçimin e plotë të këtij krimi. Është obligim i institucioneve të shtetit të Kosovës, që t'i ndërmarin të gjitha veprimet e duhura, që ata, të cilët e përgatitën, e realizuan dhe e fshehën vrasjen e Astrit Dehari, të ballafaqohen me drejtësinë dhe ta marrin dënimin e merituar.

(Vijon)

Komuna e Prishtinës jep 120 bursa

PRISHTINË, 11 NËNTOR (ER) - Komuna e Prishtinës ka vendosur që për këtë vit akademik 2019-2020 të ndajë 120 bursa për studentët që studiojnë në universitetet publike të Kosovës. Lajmi është bërë me dije në faqen zyrtare të Komunës së

Prishtinës në "Facebook". "Komuna e Prishtinës ndan 120 bursa për studentet dhe studentët që studiojnë në universitetet publike të Kosovës për vitin akademik 2019/2020. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e

informimit publik. Aplikacioni i kërkesës merret dhe i plotësuar dorëzohet në sportelet e katit përdhës të Komunës së Prishtinës (ndërtesa e vjetër), çdo ditë pune prej orës 10:00 deri në orën 15:00", është bërë me dije në njoftimin e komunës.



Fondacioni gjerman 'Luftbrücke' dhuroi një autoambulancë për Malishevën

MALISHEVË, 11 NËNTOR (ER) - Fondacioni gjerman "Luftbrücke", në ceremoninë e festimit të 30-vjetorit të themelimit, që është mbajtur më 7 nëntor të këtij viti, i ka dhuruar Komunës së Malishevës një autoambulancë për nevojat e ofrimit të shërbimeve shëndetësore. Pronarë të këtij fondacioni janë Rudolf Broer dhe Rudolf Rodenbroker, të cilët, në ceremoninë e mbajtur në Gjermani, ia kanë dorëzuar donacionin kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begaj. Me këtë rast, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi, Liridon Hoti, e kanë falënderuar fondacionin dhe përfaqësuesit e saj për këtë donacion të radhës, i cili ka rëndësi të madhe për ofrimin e shërbimeve të shpejta shëndetësore për këtë komunë. "Ky nuk është donacioni i parë, pasi fondacioni 'Luftbrücke' në vazhdimësi e ka përkrahur

Malishevën me donacione konkrete, sidomos në fushën e shëndetësisë dhe për këtë Komuna e Malishevës ju është mirënjohëse përjetësisht", ka thënë Begaj.

Në këtë takim, krahas përfaqësuesve të shumtë të fondacionit, ishte i pranishëm edhe një delegacion nga Komuna e Malishevës, në përbërje të Ragip Begaj, kryetar i komunës, pastaj drejtori për Shëndetësi, Liridon Hoti, shefja e kabinetit të kryetarit, Blerta Krasniqi dhe këshilltari ligjor Muharrem Morina.

Në këtë ceremoni delegacioni nga Malisheva është takuar edhe me përfaqësues të jetës shoqërore dhe politike të Gjermanisë, përfshirë edhe Hartmut Schauerte, sekretar i ish-kancelarit Helmut Kohl, dhe përfaqësues të bizneseve gjermane, me të cilët është biseduar për zhvillimin ekonomik dhe për mundësitë e përkrahjes për Komunën e Malishevës.



Bizneset vazhdojnë ta respektojnë orarin e punës në Mitrovicë



MITROVICË, 11 NËNTOR (ER) - Drejtuar nga kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, dhe në prani të nënkryetarit Faruk Mujka, është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve, në të cilën janë diskutuar disa pika të rendit të ditës që janë me interes për qytetarët e kësaj komune. Fillimisht drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci, ka njoftuar bordin për shfaqjen e premierës së teatrit të qytetit, "Kur

treni vonohet", me autor Osman Goranci dhe me regji të Artan Tmavës, e cila do të shfaqet më 13 nëntor, duke filluar nga ora 19:00 në Qendrën e Kulturës "Rexhep Mitrovica". Ndërsa drejtori i Inspeksionit, Hysni Ahmeti, ka theksuar se inspektorët komunalë në bashkëpunim me Policinë e Kosovës më 9 nëntor kanë mundësuar që rruga "Vëllezërit Dragaj" të jetë e lirë për qarkullim dhe nuk ka pasur pro-

dukte të ekspozuara në trotuare. Po ashtu, drejtori Ahmeti ka thënë se më 10 nëntor kanë inspektuar subjektet afariste lidhur me vendimin për respektimin e orarit të punës, me ç'rast vendimi që dita e diel të jetë ditë pushimi për të gjitha bizneset në Mitrovicë është duke u respektuar në përpikëri. Në këtë takim bordi ka diskutuar edhe një sërë temash që ndërlidhen me mirëqenien e qytetarëve.

Largohen mbeturinat në parkun e "Kamenicës"

DRENAS, 11 NËNTOR (ER) - Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë në Drenas, përmes kompanisë së kontraktuar, ka bërë largimin e të gjitha mbeturinave në parkun e "Kamenicës" në fshatin Gllobar. Pas largimit të të gjitha mbeturinave në këtë park, të hedhura nga qytetarë të pandërgjegjshëm, e që nuk është hera e parë që kjo drejtori merr këtë aksion për

largimin e tyre, ka vendosur sërish kontejnerë në hyrje të këtij parku për mbeturina e, po ashtu, është vendosur edhe tabela njoftuese. "Komuna e Drenasit, përkatësisht Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, mbetet e përkushtuar për zbatimin e praktikave të mira për menaxhimin e mbeturinave duke larguar kështu të gjitha deponitë ilegale dhe

shtrirjen e menaxhimit në secilin vendbanim, duke fituar edhe grante të performancës së mirë në ruajtjen e mjedisit, prandaj kërkojmë nga të gjithë qytetarët të jenë të përkushtuar për ruajtjen e ambientit dhe të jenë bashkëpunues me Komunën e Drenasit në mënyrë që të kontribuojmë në një mjedis më të pastër", është thënë në njoftimin për media.



Dëliri ballkanik i Edi Ramës



Shkruan: Bedri ISLAMI

Shumë vjet më parë, në njërin nga idetë e tij të çastit dhe që shumë shpejt i kuptonte se ishin të çmendura, Adem Demaçi, një nga shqiptarët më të njohur të kohës për ndjenjën kombëtare dhe lirshmërinë e shpirtit, shpalli, krejt befas, idenë e tij për Ballkanin.

Ishte e papritur, një lloj shkrepeje e beftë dhe e çoroditur, si mund të ndodhë me shumë gjëra të papjekura dhe që shkrepin në një çast hutimi politik apo, edhe më tej se kaq, kur halucionacioni politik të bëhet ves i të menduarit të politikës.

Adem Demaçi ishte një njeri i politikës që shpeshherë ngulte këmbë në të vetën deri në fund por, në raste të tjera, po kaq befas nuk e kishte për turp të prapëj, sipas devizës së tij të njohur se, "vetëm i marri dhe i vdekuri nuk ndryshon".

Kur ai shpalli "doktrinën" e tij për Ballkanin, bëra shkrimin "Ballkania mos ardh të kurrë, o Adem Demaçi!" jo vetëm si një mendim timin vetjak, por si qëndrim politik të një strukture që kishte ngritur një forcë të furishme çliruese, si ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe, në fakt, megjithëse Demaçi ishte, ndoshta, njeriu më i dashur për ata që do të luftonin, askush nuk e mbështeti në teorinë e tij.

Demaçi gjeti burrërinë e tij dhe u tërhoq. Nuk e kisha menduar se 21 vjet më pas, një tjetër figurë politike shqiptare do të kthehej në këtë ide dhe, për më tepër, të përgjysmuar dhe të cunguar, në krahun e një shteti që, pasi ka humbur hegjemoninë ballkanike, çka e sjell gjithnjë në ëndrrën e tij që, i dalë nga tri lufta, pikërisht në këtë tokë ballkanike, ende nuk ka zënë mend nga e shkuara dhe nuk e sendërton dot të ardhmen, pa nacionalizmin e tij nallçanik.

Kur e takova Demaçin, pas shpalljes së idesë së tij, i pata thënë në mirëdashje se, "bacë, po shkon drejt idesë së Titos për të pasur një federatë ballkanike dhe ti e di se në këtë panel nuk mund të futet askush dhe asgjë nuk të çon drejt së mirës". Edhe i pata shkruar, por Demaçi, ashtu i sinqertë si ishte dhe i hapur deri në fund, qeshi dhe, pak ditë më pas, e harroi idenë e tij.

Tani, Rama, me bujë dhe me pozat e një shtetari që sheh gjithë truallin ballkanik si fushën e vet të politikës, si duket ka

gjetur lojën e tij të re dhe është marrosur pas idesë së Minishengenit apo një "principate minibalkanike", ku, sipas rotacionit, ai do të jetë një nga tre princërit.

Si shumë gjëra të tjera, sidomos në dy vjetët e fundit, edhe kësaj here, me gjithë petkun evropian që mundohet ta mbështjellë, Rama paraqitet si një politikan province, që i zemëruar se nuk arriti t'ua mbushë mendjen zotërinjve të mëdhenj të Evropës, vendos të hapë një lojë luftërash në oborrin e shtëpisë së vet dhe duke e kaluar topin here pas here edhe te fqinjët.

Çfarë ishte ky Minibalkan apo Minishengen që, në të vërtetë, nuk ka asgjë të ngjashëm me Shengenin e vërtetë dhe as me shkarkimin e ngarkesave ballkanike. Dy a tri ditë më parë, shefi i emëruar i diplomacisë shqiptare, i cili vjen nga viset shqiptare në Kosovë, bëri përcaktimin e saktë të një shteti fqinj, Serbisë, si vend me ngarkesa dhe faje të mëdha të së shkuarës. Një përcaktim i saktë që, ndoshta, mund të shkohet edhe më tej, si një vend që, në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit të shkuar, mbi kurrizin e tij ka tri luftëra, ku janë humbur më shumë se 100 mijë jetë njerëzore, janë bërë masakra të pafund dhe që asgjë nuk ka mësuar nga e shkuara.

Pikërisht, është shteti serb që ka shërbyer këtë ide, si një lloj paradhome tek e cila mund të strehohen lehtësisht ide të çoroditura, disa nga të cilat rrjedhin nga "Naçartanja" e disa të tjera mund të vijnë edhe nga stepat e politikës ruse, të cilat, si zakonisht, ngrijnë rrugën shqiptare drejt Evropës.

Një krijesë e tillë nuk mund të jetë kurrë Minibalkan, pasi Ballkani nuk përbëhet nga vetëm tri shtete, por është shumë më i gjerë, më i hapur dhe më paneuropian sesa Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria. Që të ketë një Minishengen do të duhej të ishin, edhe kështu do të ishte një lidhje e mangët, Bullgaria, Rumania, Greqia, Kroacia, Sllovenia, Bosnja, Mali i Zi, Turqia, pra, një përziere mes shteteve me politika të ndryshme, qëndrime të ndryshme dhe të përfshira në pjesë të ndryshme. Disa prej tyre janë pjesë të NATO-s të tjerat, jo; disa bëjnë pjesë në Bashkimin Evropian, të tjerat, jo; disa kanë aspirata më të mëdha, të tjerat ende nuk kanë kaluar pragun e shtëpisë së tyre.

Shqipëria, përmes shefit të qeverisë dhe, deri tani, askush nuk e di se si i lindi kjo ide, kërkon të krijojë një aleancë me Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut dhe e kanë marrë me aq vrull dashuronjës, sikur koha e

deritashme nuk kishte qenë e mjaftueshme.

Me cilët?

Serbia, në Kushtetutën e saj, e përcakton Kosovën si një pjesë të saj dhe qëndrimet e deritashme të saj nuk kanë lëvizur dhe, siç duket, as nuk kanë ndër mend të lëvizin. Jo vetëm kaq, por që 20 vjet kur, de fakto, Kosova u bë e lirë, ajo nuk ka reshtur së bëri gjithë makinacionet e botës, që nga më të hapurat e deri më të mbyllurat, për t'i prerë rrugën asaj në çdo hap që ka hedhur apo që mund të hidhte. Miliona euro po harxhon qeveria serbe, që shtete të ndryshe t'i tërheqin njohjet e bëra më parë ndaj shtetit të Kosovës; dhjetëra milionë të tjera po shpërndan për të mbjellë destabilitet dhe pasiguri, shpërndan miliona për ta rrënuar pavarësinë e saj dhe për të krijuar një gjendje të paqëndrueshme. Synimi i Serbisë, i shprehur edhe përmes liderëve serbë me të cilët sot bashkërendon Edi Rama, është të shpëputin sa më shumë pjesë të Kosovës, në ndarjen e saj, ridefinimin e kufirit...

Rama theksoi se Kosova u vetëpërkrahua, por nuk e mendoj se me cilin status do të ishte Kosova aty, në mexhliet e bashkëbisedimeve serbo-shqiptare-maqedonase?

Si shtet në vete, që Serbia nuk e ka njohur, si krahinë - që tashmë është miopi ta mendosh, si Republikë... me cilin status do të vendosë dhe kush mund të jetë ai lider shqiptar në Kosovë që do të mund të marrë përsipër një barrë të tillë, e cila, në një kohë jo të vonët, mund të ishte trajtuar, jo pa të drejtë, si akt tradhtie ndaj vendit të tyre.

Përcaktimi i Kosovës si pjesë e

Serbisë e përjashton atë nga takime të tilla, pasi në Kushtetutën serbe, si Kosova, si Vojvodina, kanë status të njëjtë... Por, edhe nëse liderët në Kosovë kanë një çast çmendurie dhe e përkrahin këtë ide, përsëri mbetet e prapstë, e dëmshme dhe hap shumë prapa në politikën shqiptare drejt Evropës.

Pastaj, nga do ta bëjnë Vuçiqi dhe Rama lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të mallrave? Përmes Maqedonisë së Veriut? Përmes Malit të Zi? Duke e izoluar, injoruar dhe mos njohur Kosovën? Nëse e bën përmes Kosovës, si do ta njohë Rama shtetin e Kosovës? Po presidenti serb?

Për Ramën është më e lehtë të hedhë në gjyq ish-kryeministrin e Kosovës sesa të merret vesh me të, të paktën sa gjysma e asaj që po mirëkuptohet budallshëm me presidentin serb!

Gjërat duhen bërë me themel, duke u nisur nga kombëtarja dhe duke shkuar drejt infinitit internacional. Nëse Rama dhe Zajev kanë të njëjtin hall, portat që u mbyllën, qoftë edhe përkohësisht, për të shkuar dikur në Evropë, dinjitoz dhe të mirëpritur, kjo nuk ka të bëjë me atë që është përjetuar në trevat shqiptare jashtë Shqipërisë londineze.

Politikan modern nuk mund të jesh, ndërsa e quan arkaike nacionalen, nëse shfaqesh i hapur, deri në shqyerjen e portave, me njerëz të politikës, të cilët më përpara mendojnë copëtimin e shtetit të Kosovës dhe përfshirjen e Shqipërisë në një ëndërr të vjetër pansllave.

Dy nga shtetet e përfolur, liderët e të cilëve po përqafohen deri në mallëngjim, nuk janë pjesë e NATO-s. Shqipëria është. Ajo bën pjesë në një strukturë të për-

bashkët më fuqitë më të mëdha perëndimore. Mbështetet prej saj, në të njëjtën kohë kur Serbia mbështetet nga perandoria ruse me armët më të sofistikuar. Kundër kujt përgatitet shteti serb? A nuk i mjaftuan tri lufta në Ballkan dhe mendon se mund të ketë një të katërt?

Përfitimet e përfolura, për kalime të lira të kufijve, vetëm përmes një dokumenti, çka ekziston me Maqedoninë e Veriut, lehtësimi i tatimeve dhe çlirime të tjera financiare, po ashtu, nuk janë në dobi të shtetit shqiptar, i cili ende nuk e ka gjetur rrugën e duhur në bashkëpunimin me Kosovën, e cila, edhe pse vendosi një taksë 100 për qind ndaj shtetit serb, nuk përfitoi si e sa duhej nga ekonomia e shtetit shqiptar.

"Kosova u vetpërkrahua" - deklaroi shefi i qeverisë shqiptare, i cili i ka hyrë në këmbë një aventure të pazakontë dhe pa pasur miratimin e asnjë strukture tjetër, pa u konsultuar me historianë, ekonomistë, politikanë, me akademikë, njerëz të mençur, çka e ka bërë prej kohe shteti serb.

Aventura e tashme mund të jetë e dobishme, për pak kohë, për imazhin e shefit të qeverisë në vendet e ndërlidhura në këtë Minibalkan, por do të jetë e dërmuar në bashkëkombësit e tij. Euforia nuk është shenjë e suksesit dhe e dobisë.

Euforia është çasti që sjell dëshpërim.

Në fund të fundit, ky vend nuk është çiflig i askujt, aq më pak i një njeriu që, duke qenë kryeministër, mendon se mund ta sjellë atë në majën e gishtërinjve të dorës së djathtë. Shteti dhe kombi nuk duhet të paguajë për dëlirin e askujt!



DY FJALË PËR DREJTORIN, MIKUN, KOLEGUN ROLAND KAÇANI -'LANDI'



Bali MAHMUTI

Jeta shpeshherë bën të sajën, pa pyetur për dëshirat e njerëzve të shumtë që do të donin ta kishin pranë Roland Kaçanin edhe për shumë vjet të tjera. Edhe ne miqtë, kolegët, shokët e familjarët nuk kemi ç' të bëjmë tjetër veçse t'i shfletojmë kujtimet dhe, njëkohësisht, ta shprehim respektin e thellë për shokun tonë që u largua para kohe, papritur, në një moshë ende të re, kur kishte ende shumë për t'i dhënë shoqërisë, vendit dhe familjes së tij.

Roland Kaçani ishte pionier në fushën e sigurimeve në trojet shqiptare dhe më gjerë. Ai vuri themelet në lëmin e sigurimeve në territoret shqiptare, e avancoi këtë sektor në Kosovë dhe në Shqipëri në stadin e sigurimeve evropiane, e modernizoi atë duke bërë përpjekje ditë e natë për t'i ngjarë sa më shumë sektorit të sigurimeve evropiane. Ishte nga ata bredhës që vazhdimisht kërkonte shtegun e duhur dhe për këtë nuk e fillonte ditën e sotme aty ku e kishte përfunduar të djeshmen, ashtu siç edhe perëndimi i diellit nuk na gjen aty ku na ka lënë lindja e tij.

Vdekja tragjike e Roland Kacanit, drejtorit të Kompanisë së Sigurimeve "SIGMA"

Interalbania vig sh. a. - Dega në Kosovë, është një humbje e madhe për komunitetin e biznesit, e sidomos të komunitetit të fushës së sigurimeve në Kosovë dhe në Shqipëri. Kontributi i tij për çuarjen përpara të rrjedhave biznesore shqiptare dhe për avancimin e veprimtarisë së sigurimeve në territoret shqiptare është i pashlyeshëm. Ishte njeri me dije, gjuhë, kulturë e vizion, njeri që komunikonte me gjuhën dhe logjikën evropiane. U imponua në lëmin e sigurimeve me aftësi të pashoqe, me përkushtim dhe me korrektësi shembullore. Këtë e arriti duke studiuar këtë lëmë që, në thelb, duke vazhduar pareshtur aftësimin profesional dhe duke përvetësuar dhe aplikuar

përvojat dhe standardet më të avancuara evropiane në këtë fushë. Ai e kishte synim primar që lëmin e sigurimeve ta bëjë të besueshëm për profesionalizmin dhe korrektësinë ndaj klientelës. Ai nuk reshti dot së kërkuari që të aplikohet standardi i respektimit, në radhë të parë të klientit, të të dëmtuarit. Në këtë mënyrë e krijoi autoritetin e tij prej një profesionisti të pashoq, si dhe ngriti kompaninë e sigurimeve "SIGMA" interalbanian vig sh. a. në standin e kompanive lidere jo vetëm në Kosovë dhe Shqipëri, por edhe në rajon e më gjerë. Ai në vitet e pasluftës në Kosovë u angazhua fuqishëm për t'i përbashkuar sa më shumë rregullat dhe normat ligjore të sigurimeve në Kosovë dhe në Shqipëri. Ishte i veçantë

në ngulmimin e tij që të unifikohet legjislacioni ndërshqiptar i sigurimeve dhe në këtë aspekt ai shërbeu si urë ndërlidhëse ndërshqiptare.

E deshën të gjithë ata që e njohën në Shqipëri, Kosovë e më gjerë, dhe nuk ishin të paktë. Të gjithë do ta ndiejmë gjatë mungesën e tij, familja, shoqëria, bashkëpunëtorët, e veçanërisht ne që kemi pasur fatin të punojmë së bashku në tregun e sigurimeve, gjegjësisht në kompaninë e sigurimeve "SIGMA" interalbania vig sh. a. - Dega Kosovë, që ishte edhe vetë jeta e tij, ku falë vizioneve të Rolandit u bë e njohur dhe me shumë reputacion në industrinë e sigurimeve jo vetëm brenda Kosovës, por edhe më gjerë.

Njeri i shquar për dije, për shpirtin e ndërmarrësisë, por edhe për korrektësinë e sinqeritetin e pashoq. Realizimet e projekteve të tij, debatet e tij, leksionet e tij, organizimi që bëri ndër vite kompanisë së sigurimeve "Sigma", për ne do të mbeten shenja kujtuese të përhershme e të shtresuara thellë në ndërgjegjen tonë. Duhet folur paksa edhe për Rolandin njeri jashtë punës, për Rolandin të cilit familja dhe ne miqtë e tij të afërt do t'ia ndiejmë mungesën. Pak njerëz kemi njohur në jetë që ta kishin mirësinë e tij në shpirt dhe

ndjenjën e përgjegjësisë ndaj të afërmeve në nevojë; karakteristikat e tij si një fëmijë shembullor për prindërit, vëlla i pashoq për motrën dhe vëllanë, xhaxha, dajë i pashoq për nipërit dhe mbesat.

Njeri që rrezatonte veç ndjesi pozitive dhe që nuk e dëgjoje asnjëherë të fliste keq për askënd. Shembull tolerance, qytetarie e virtyti... njeri që kur e takonim na indukonte me pozitivitetin dhe energjinë që e tejçonte aq bindshëm të ne.

I ndritë shpirti për jetë se ishte shok bujar, burrë dhe njeri i mirë që do të mbetet shembull dhe krenari familjare, shoqërore, patriotike dhe intelektuale për ta pasur lakmi. Sepse ai shkoi për të mbetur me ne - përgjithmonë. Është ky ligj i amshueshëm i Zotit!

Landi, po largohesh duke na lënë një zbrazëti të pambyllshme.

Do të na mungojë prania jote, fjala jote, e qeshura jote, këshilla jote e mençur!

Ti shkove befasisht, duke na lënë të trishtuar dhe të tronditur, por do të jesh gjithmonë me ne dhe ne do t'ia vazhdojmë projektet e mëdha që na i le. Lamtumirë Drejtor, shok, mik i shtrenjtë!

U prehsh në paqe dhe i përjetshëm qoftë kujtimi yt!





AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

Presidenti Trump flet në Nju Jork për Ditën e Veteranëve

WASHINGTON, 11 NËNTOR - Presidenti Trump mbajti një fjalim në hapje të paradës së veteranëve në qytetin e Nju-Jorkut me rastin e festimit të Ditës së Veteranëve. "Ky vend ju ka përjetë borxh dhe ne ju falënderojmë të gjithëve", tha

Trumpi, i cili është presidenti i parë në histori që merr pjesë në paradën e veteranëve në Nju-Jork, më e madhja në vend.

Në ShBA, Dita e Veteranëve, e njohur fillimisht si Dita e Armëpushimit, është ditë

pushimi dhe kremtohet çdo vit më 11 nëntor, për t'i nderuar veteranët e ushtrisë. Ajo përkon me ditë të ngjashme që përkujtohen në vende të tjera dhe që shënojnë mbarimin e Luftës së Parë Botërore. Me këtë rast, në

Varrezat Kombëtare të Arlingtonit, pranë kryeqytetit Uashington, zhvillohen çdo vit ceremoni me fjalime dhe vënie kurorash me lule. Këtë vit presidenti Trump zgjodhi ta përkujtojë Ditën e Veteranëve jashtë Uashingtonit.



Partia Socialiste fiton zgjedhjet në Spanjë

Pasi Partia Socialiste ka fituar më së shumti vota në zgjedhjet e së dielës në Spanjë. Kryeministri Pedro Sanchez ka thënë se është prioritet i tij që të formojë qeveri stabile dhe të bëjë politikë për të përfituar shumica e spanjollëve

MADRID, 11 NËNTOR - Socialistët që kanë qeverisur deri më tani në Spanjë kanë fituar më së shumti vota në zgjedhjet e së dielës, mirëpo kanë humbur shumicën meqë partitë e krahut të djathtë kanë shënuar fitore të mëdha.

Partia Popullore konservatore është renditur e dyta dhe partia e të djathtës ekstreme, Vox, ka fituar më shumë se dyfishin e votave në krahasim me zgjedhjet e kaluara, duke u shndërruar në partinë e tretë më të fuqishme në këtë shtet.

Këto kanë qenë zgjedhjet e katërta që janë mbajtur në Spanjë në katër vjetët e fundit. Në procesin zgjedhor të mbajtur në muajin prill nuk ka pasur shumicë të qartë, andaj socialistët kanë dështuar që të formojnë koalicion qeveritar. Këtë herë socialistët kanë fituar 120 ulëse nga 350 sa janë në total, apo tri më pak në krahasim me zgjedhjet e muajit prill.

Teksa u është drejtuar mbështetësve socialistë pas shpalljes së rezultateve, kryeministri Pedro Sanchez ka thënë se është prioritet i tij që të "formojë qeveri stabile dhe të bëjë politikë për të përfituar shumica e spanjollëve". "Dëshiroj t'ua bëj thirrje të gjitha partive politike, që të

veprojnë me përgjegjësi në mënyrë që të zhblokohet situata politike në Spanjë", ka thënë ai. Pas dështimit për ta formuar qeverinë, Sanchez kishte shprehur se mbajtja e zgjedhjeve të reja do ta fuqizonte dorën e partisë së tij, mirëpo Pablo Iglesias, lider i krahut të majtë, Podemos, ka paralajmëruar se ky proces vetëm ka forcuar të djathtën ekstreme. "Edhe një herë ne i zgjasim dorën Partisë Socialiste dhe Pedro Sanchezit", ka thënë ai, duke bërë të ditur se është i gatshëm për t'i nisur bisedimet me këtë parti.

Podemos është aleat politik natyral i Partisë Socialiste. Megjithatë, një koalicion në mes të të dyja grupeve sërish nuk do ta arrinte numrin e duhur për shumicë parlamentare. Partia e të djathtës ekstreme, Vox, konsiderohet se ka përfituar nga situata në Katalonjë dhe ndjenja e fortë antiseparatiste në rajone të tjera të Spanjës. "Sot në Spanjë është bashkuar një mundësi patriotike dhe një mundësi shoqërore, e cila kërkon unitet kombëtar për rregullim të rendit kushtetues në Katalonjë", ka thënë lideri i partisë Vox, Santiago Abascal, para mbështetësve të tij.



Philippe Marcou (AFP)

Rritja e shpejtë e partisë Vox është kthyer në një prej pikave kyçe të diskutimit.

Spanja është paraqitur imune para valës në rritje të populizmit të së djathtës ekstreme në kontinent në dekadën e fundit, ndonëse ky vend është përballur në të kaluarën me

diktaturën ushtarake të gjeneralit Francisco Franco.

Mirëpo tani Vox ka krijuar idenë se është forcë e madhe në politikën spanjolle.

Liderja e partisë të së djathtës ekstreme në Francë, Marine Le Pen, ka uruar përmes një postimi në "Twitter", partinë

Vox, për "suksesin e jashtëzakonshëm".

Popullisti italian Matteo Salvini ka folur me gëzim për suksesin e partisë Vox. "Aspak racizëm dhe fashizëm, në Itali dhe në Spanjë ne vetëm duam të jetojmë në paqe në shtëpinë tonë", ka thënë ai në "Twitter".

Turqia nis kthimin e terroristëve të huaj në vendet e origjinës

ANKARA, 11 NËNTOR - Autoritetet turke thanë të hënën se kanë nisur kthimin e xhihadistëve të huaj në vendet e tyre të origjinës. Një amerikan tashmë është dëbuar, ndërsa disa evropianë janë në proces të dëbimit nga Turqia, tha zëdhënësi i Ministrisë së Brendshme turke, Ismail Catakli. "Një luftëtar i huaj terrorist nga Shtetet e Bashkuara është dëbuar pasi janë kryer të gjitha procedurat. Planet e udhëtimit për shtatë luftëtarë terroristë me origjinë

nga Gjermania kanë përfunduar po ashtu dhe ata do të dëbohen më 14 nëntor", tha Catakli.

Shtetet e Bashkuara dhe Gjermania nuk kanë bërë ende asnjë koment.

Javën e kaluar, ministri i Brendshëm turk, Suleyman Soyly, është zotuar se do t'i kthejë në vendet e origjinës të gjithë xhihadistët e huaj. Ai ka thënë se Turqia ka në paraburgim mbi 1 200 luftëtarë të huaj të grupit militant Shteti Islamik.

Turqia i ka kritikuar vendet

perëndimore që kanë refuzuar t'i riadhesojnë shtetasit e tyre, që i janë bashkuar Shtetit Islamik në Siri dhe Irak, madje duke ua marrë disave edhe shtetësinë. Nuk është e qartë nëse Turqia do të jetë në gjendje t'i riadhesojë ata që e kanë humbur shtetësinë.

Edhe pse me Konventën e Nju Jorkut të vitit 1961 është jolegale që të lihet dikush pa shtetësi, disa vende, përfshirë Britaninë dhe Francën, nuk e kanë rati-fikuar atë.



Filmat që duhet të shikoni në muajin nëntor



(Credit: Universal Pictures)

© Universal Pictures

Për fansat e filmave dhe aktorëve të njohur të kinematografisë botërore nëntori do të jetë i mbushur me histori interesante. Më poshte janë të listuara 7 filmat që kanë dalë dhe pritet të dalin në kinematë botërore për muajin nëntor bashkë me historinë e tyre

1.Na vjen keq që ju kemi munguar

Ken Loach mund të jetë 83 vjeç, por regjisori i madh britanik me ndihmën e skenaristit të tij, Paul Laverty, ai është shumë i naftë në kinema.

Historia përqendrohet në Rickyn (Kris Hedding), një njeri që mban familjen e tij duke drejtuar një furgon shpërndarjeje. Filmi është vlerëzuar për meszhin e dhumbshëm që pëercjell dhe ndan të njëjtën pyetje që Loach ka bërë për më shumë se 50 vjet: a duhet të jetë vërtet jeta si kjo?

Do të publikohet më 8 Nëntor në Finlandë dhe Norvegji dhe 14 Nëntor në Itali dhe Hollandë.

2.Krishtlindja e kaluar

Elton John, Bruce Springsteen,

The Beatles ... kanë frymëzuar të gjithë filmat nostalgjikë në dy vitet e fundit.

Dhe tani është radha e George Michael. Një komedi romantike festive me një sëmundje kronike në të.

Ylli i Krishtëlindjes së fundit Emilia Clarke (Game of Thrones), e cila punon si asistente dyqanesh me një jetë në Londër është rrëmujë.

Henry Golding (Crazy Rich Asians) është beqari që do t'i rregullojë jetën asaj.

Por ku është George Michael në film? Por regjisori i filmit, Paul Feig dhe bashkë-shkrimtarja, Emma Thompson, premtojnë se lidhja është atje. Thjesht duhet të kesh besim.

Do të publikohet në 7 Nëntor në Australi dhe Zelandën e Re, 8 Nëntor në SHBA dhe Kanada dhe 15 Nëntor në MB dhe Irlandë.

3.Engjëjt e Charlie

Engjëjt e Charlie do të sjellë një risi të serialeve televizive të viteve 1970, për të mos përmendur dy filmat nga 2000 dhe 2003, versioni i ri është mjeshtëruar nga Elizabeth Banks, filmi i parë me metrazh i të cilit si regjisor ishte Pitch Perfect 2.

Ngjarja është mes një ndërmetjetësi midis misteriozit Charles Toënsend dhe detektiveve femra që ai paguan për të shkuar në aventura.

Engjëjt e fundit të Charlie janë Kristen Steëart, Ella Balinska dhe Naomi Scott, megjithëse ata do të përpiqen të tejkalojnë treshen që regjistroi këngën me temë të filmit, Ariana Grande, Miley Cyrus dhe Lana Del Rey. Filmi do të publikohet në 14 nëntor në Australi dhe Hong Kong, 15 nëntor në SHBA, Kanada dhe Meksikë dhe 29 nëntor në MB dhe Irlandë

4.Queen & Slim

Queen & Slim është një thriller romantik i shkruar dhe drejtuar nga dy gra me ngjyrë.

Regjisoria është Melina Matsoukas, krijuesja fituese e Grammy pas videove të shumta të Beyoncé, dhe skenaristja, Lena Èaithe, është krijuese fituese e Emmy-t e Chi-së.

Së bashku ata kanë bërë të ashtuquajturin "Bonnie dhe Clyde", por ata nuk duan që të përshkruhet ashtu.

Në film do të krijohet panik, ku nga vajzat do të qëllonjë një polic dhe së shpejti çifti do të udhëtojë në SHBA.

Filmi do të publikohet në 27 nëntor në SHBA dhe Kanada.

5.Frozen II

Frozen ishte një nga filmat më të shikuar derisa u shfaq Lion King.

Filmi Frozen II do të tregojë se si Elsa, Anna, Olaf dhe Kristoff do të largohen nga Arendelle për të kërkuar burimin e magjisë së akullit të Elsa-s.

Edhe pse miliona fëmijë që e pëlqyen filmin e parë janë më të rritur tani, shpresojmë që të pritet përsëri mirë.

Filmi do të publikohet në 20 nëntor në Gjermani e Francë dhe 22 Nëntor në MB dhe SHBA

6.Harriet

Harriet Tubman është një nga figurat më heroike të lëvizjes eliminatore në SHBA.

Lindur në sklavëri në Maryland, Tubman bëri një arratisje të guximshme në Filadelfia dhe më pas u kthye në Jug për të ndihmuar në çlirimin

e dhjetëra robërve të tjerë.

Planet për të vendosur portretin e saj në 20 dollarëshin, u vonuan në fillim të këtij viti, por për të është realizuar një biografi e drejtuar nga Kasi Lemmons, dhe duke interpretuar Cynthia Erivo së bashku me Janelle Monae.

Është publikuar më 1 nëntor në SH.B.A. dhe do të jetë në 22 Nëntor në Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandë.

7.Një ditë e bukur në lagje

Tom Hanks do të marrë pjesë në film, ku do të jetë mikpritësi i lagjes së Mister Rogers për më shumë se 30 vjet.

Fred Rogers ishte një ikonë e televizionit të fëmijëve parashkollorë.

Tani Marielle Heller drejton një biografi, në të cilën një gazetar me probleme, Mattheë Rhyështë caktuar ta intervistojë atë.

Caryn James, gazetari i kulturës së BBC-së admiron emocionin autentik dhe thotë se "Një ditë e bukur në lagje, rezulton të jetë diçka e rrallë.

Një film që do t'ju sjellë ngrohtësi sa edhe cinikët do ta duan. Filmi do të publikohet në 22 nëntor në SH.B.A. dhe Kanada dhe 27 Nëntor në Indonezi dhe 28 Nëntor në Singapor.

E rrallë

Makina fluturon në ajër dhe hyn në katin e dytë të banesës

Dy persona humbën jetën pasi një automjet tip "Porsche" ka 'fluturuar' në ajër dhe është përplasur në katin e dytë të një ndërtese. Aksidenti aspak i zakonshëm ndodhi në New Jersey. Në timon ishte një 22-vjeçar. Bashkë me të në makinë ndodhej edhe një pasagjer, 23-vjeçar. Si duket shoferi i automjetit ishte duke ecur me shpejtësi shumë të lartë dhe



në çastin që u përplas me një barriërë ndarëse në rrugë, makina fluturoi në ajër e më pas u përplas në katin e dytë të ndërtesës aty pranë.

FOTO E DITES



Kuajt e Islandës shihen duke lozur në Wehrheim afër Frankfurtit. /AP/

E jashtëzakonshme

Nëna gati sa nuk vdiq pasi djali i saj nuk dinte matematikë

Mediat në Azi kanë raportuar se një grua gati sa nuk vdiq pasi djali i saj nuk mundi të bënte një korigjim matematikor pas provave të shumta. Sipas raportimeve të gazetës në gjuhën kineze me qendër në Malajzi, "Sin Chew Daily", gruaja 36-vjeçare jeton në provincën Hubei dhe ka një djalë që ndjek klasën e tretë. Kjo ndodhi në fillim të nëntorit, kur ajo po ndihmonte djalin



në detyrat e shtëpisë. Djali nuk arriti të përgjigjej saktë disa herë, gjë që acaroi gruan. Sipas raportimeve, ajo thirri burrin pasi kishte vështirësi në frymëmarrje dhe më pas u dërgua në spital.

BARSOLETA E DITËS



Shkon një vajzë në ëmbëltore dhe porosit një torte.
Kamerieri e pyet: A me shllag a pa shllag?
Vajza: Normalisht qe pa shllagë! A nuk po sheh se jam duke mbajtur dietë?!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:00

ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.
Regjia: Jill Culton



Çdo ditë në ora 16:00

TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.
Regjia: Josh Cooley



Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.
Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.



DASHI

Me shumë mençuri


arrini të menaxhoni çdo lloj situatë që jua afron dita.



DEMI

Edhe pse sot persona afër jush ju

ndiejnë larg e jo të përfshirë në biseda, kjo është një strategji e mirë për të mos dalë kundër tyre.



BINJAKËT

Projekte të reja dhe ecje të reja në

karrierën tuaj profesionale po paraqiten në horizont. Do t'i kapni në ajër dhe do të përfitoni nga kjo gjë.



GAFORRJA

Në çështje pune dhe ato familjare

jeni autoritar dhe jepni gjithmonë zgjidhjen përfundimtare. Njerëzit që keni pranë besojnë te ju.



LUANI

Sot do të përfundoni gjithçka që keni

lënë pezull nga java e kaluar. Shpirti juaj i iniciativës sot do të jetë vendimtar për zgjidhjen e problemeve.



VIRGJËRËSHA

Nuk është e nevojshme të

jepni mend edhe për ato çështje që nuk i njihni mirë. Ndonjëherë të dëgjosh zgjidh më shumë punë sesa të flasësh.



PESHORJA

Do të jeni rebel dhe nervoz sot dhe pa

ndonjë shkak ose arsye. Kjo gjë do t'ju bëjë të jepni vendime të dyshimta lidhur me disa çështje.



AKREPI

Ndjenjat dhe emocionet sot do të jenë

primare në ditën tuaj. Çdo gjë duket se shkon ashtu siç duhet dhe do të udhëhiqeni nga zemra.



SHIGJETARI

Mos lejoni që stresi ta shkatërojë

ditën e sotme. Edhe pse do të keni disa vonesa në çështje të caktuara, nuk është fundi i botës.



BRICJAPI

Keni plane afatgjata lidhur me

një person të caktuar. Por, do të ishte mirë që dhe ai të ishte në dijeni të ndjenjave tuaja për të.



UJORI

Problemet që mund t'ju dalin sot në

punë, mund t'i zgjidhni vetëm duke ruajtur qetësinë dhe pa ju kapur paniku.



PESHQIT

Gjithë dita juaj sot do të

kalojë në një pësjtjellim ndjenjash dhe arsyesh e nuk po dini të ndani disa gjëra që ju shqetësojnë.



Aktorja e njohur heq me laser tatuazhin

Sarah Hyland, 28-vjeçare, ka vendosur të heqë një tatuazh nga vithet. Aktorja së fundmi ndau pamje nga një ordinancë, e shtrirë në stomak, ndërsa kishte vendosur syze mbrojtëse. "Reagimi aktual ndaj heqjes së tatuazhit me laser. Oof sa dhemb", ka shkruar ajo në rrjetet sociale. Me sa duket, Hyland ka hequr tatuazhin e dinozaurit në prapnicën e saj të cilin e ka njësoj me shoqen e ngushtë, Katie Welch.

Madona me vonesë në koncert, admiruesi i saj e hedh në gjyq këngëtarën



Ka diçka që ju të gjithë duhet ta kuptoni. Kështu e nisi Madonna performancën e saj në koncertin në Las Vegas derisa ishte e ulur mbi një piano, duke tundur këmbët. "Dhe kjo është një mbretëreshë nuk është kurrë vonë".

Superstari ua tha këto fjalë fansave gjatë koncertit të kësaj jave, duke postuar videon në "Twitter" më pas. Dhe pavarësisht prej brohoritjeve që erdhën nga turma, jo të gjithë ishin në një mendje. Një fans nga Florida tani vë bast se edhe

gjykata nuk do të jetë në një mendje. Nate Hollander do ta çojë këngëtarën në gjykatë për fillimin e vonuar të koncerteve të saj. Ai ka paraqitur një padi në Miami Dade, kundër Madonës dhe kompanisë që organizon koncertet.



Kim Kardashian në "People's Choice Awards" me fustan "Versace"

Kim Kardashian-West dhe motrat e saj Khloe dhe Kourtney goditën në tapetin e kuq me paraqitjen e tyre në "People's Choice Awards" në Los Anxhelos. 39-vjeçarja Kim u pa e veshur me një fustan mahnitës të shkrirë në lëkurë gjarpri nga marka "Versace". Kourtney mbante të veshur një kostum të ndritshëm të

kombinuara me vetëm një palë sutjena ngjyrë të zezë, ndërsa Khloe kishte veshur një fustan transparent të kombinuar me një çantë që e bënte të dukej krejtësisht elegante. Treshes së Kardashianëve iu bashkua më vonë edhe nëna e tyre, Kris Jenner, të cilat ishin në këtë ngjarje duke promovuar bashkëpunimin e tyre të ri.



Reperi Lil Pump u kafshua nga gjarpri derisa po xhironte një videoklip


Lil Pump e ka publikuar një video nga koha kur është kafshuar nga një gjarpër derisa po e xhironte një videoklip të ri. Reperi e ka publikuar xhirimin në "Instagram", duke e treguar edhe dorën e përgjakur pasi ishte kafshuar. 19-vjeçari shihet teksa e mban një gjarpër në dorë si pjesë e xhirimeve, por në momentin që e kafshon e largon atë me shpejtësi.

Enciklopedia gjithëkombëtare 'Bardhësitë e Atdheut'

Nga: Ekipi Hulumtues, Dokumentues, Botues dhe Promovues i Enciklopedisë Gjithëkombëtare, "Bardhësitë e Atdheut"

Promovimet dhe përrurimet e Enciklopedisë gjithëkombëtare me 28.777 fakte, dokumente dhe argument gjithëkombëtare, "Bardhësitë e Atdheut" e autorit, ish-reporter dhe veteran i luftërave të UÇK-së, Afrim Mustafa, po vazhdojnë. Kjo vepër, e cila përfshin 3.000 dëshmore dhe dëshmorë të luftërave të UÇK-së këto ditë është promovuar në Shkup dhe në Prishtinë, ku u vlerësua se, autori, Afrim Mustafa ka bërë punë të jashtëzakonshme gjithëpërfshirëse dhe gjithëkombëtare, duke përfshirë të gjithë dëshmorët e UÇK në Kosovë, UÇK në Kosovën Lindore dhe UÇK në Maqedoni. Njëri nga komandantët e shquar të tri luftërave të UÇK-së, por edhe të luftës në Kroaci, z. Enver Avdyli-

Rafuna, tha se, kjo vepër madhore gjigante është krenari dhe nder të çdo shqiptar dhe ajo duhet të vendoset nëpër të gjitha familjet shqiptare në Kosovë dhe në krejt trojet shqiptare. Një vlerësim të lartë për enciklopedinë gjithëkombëtare, e dha para publikut edhe veprimtari, shkrimtari dhe publicist i mirënjohur, dr. Nexhat Çoçaj, i cili veprën e përmasave gjithëkombëtare, "Bardhësitë e Atdheut" e vlerësoi, Kryevepra e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës" dhe kërkoi që e njëjta të financohet urgjentisht nga institucionet e Republikës së Kosovës edhe për t'u përkthyer. Po ashtu, fjalë të veçanta, publikisht për veprën e veçantë, tha edhe publicist i mirënjohur, shkrimtari dhe veprimtari i shquar në diasporë, z. Shefqet Dibrani, i cili theksoi se, enciklopedia "Bardhësitë e Atdheut" është Libri më universal, gjithëpërfshirës dhe më i kompletuar për dëshmorët, martirët dhe heronjtë e atdheut... Për enciklopedinë



Enciklopedia "Bardhësitë e Atdheut" me autor, Afrim Mustafa, u mirëprit dhe u promovua solemnisht nga Familja e kryelegjendarit, Adem Jashari. Në Kullën e Jasharëve, kryefamiljari, Rifat Jashari, nderoi me mirënjohje të veçantë z. Afrim Mustafa, duke falënderuar, posaçërisht për sjelljen në dritë të këtij kaptiali shumë të rëndësishëm për çdo shqiptar, kudo ku ndodhet ai... Rifat Jashari, falënderoi z. Afrim Mustafa edhe për raportimin e tij, drejtpërdrejt nga lufta e UÇK-së, nga Drenica, nga Prekazi, Prelloci, Likoshani, Qirezi, Likoci, Gllanasella, Godanci dhe Guri i Plakës, ku autori ishte, qysh nga maji i vitit 1998...




Njëra nga vajzat më të talentuara kosovare, z. Florentina Ferati nga Pleshina e Ferizajt, e cila është njëra nga inxhinieret e shquara në gjigantin social botëror, "Facebook". Tina, me respekt të veçantë ka shprehur dëshirën që ta promovojë enciklopedinë e trojeve shqiptare, "Bardhësitë e Atdheut" edhe në arenën ndërkombëtare...




Folësi i mirënjohur i RTK-së, Mustafë Muçaj, informon opinionin e gjerë në edicionin qendror të lajmeve të mediumin publik për Promovimin Solemn dhe shumë të suksesshëm të Enciklopedisë gjithëkombëtare të trojeve shqiptare, "Bardhësitë e Atdheut", të veteranit dhe ish-reporterit të luftërave të UÇK-së, Afrim Mustafa...

githëkombëtare, kanë folur, shkruar dhe publikuar edhe akademikët, intelektualët dhe publicistët e përmasave gjithëkombëtare, si: Akademikët: Esat Stavileci, Pajazit Nushi dhe Mehmet Halimi, ish-krerët e lartë të UÇK-së: Jakup Krasniqi, Sokol Dobruna, Elmi Reçica, gjeneralët: Kudusi Lama, Shukri Buja, Rustem Berisha, Rustem Mustafa, Sadik Ademi, Xhavit Jashari, Nazmi Hajredini, dr. Jahja Drançolli, dr. Don Lush Gjergji, Bilall Maliqi, dr. Sabri Kiçmari, Hazbi Lalinca, dr. Selim Daci, Kemail Shaqiri dhe shumë të tjerë. Gjatë fjalës së tij, Autori Afrim Mustafa, i cili gjatë luftës veprroi dhe raportoi drejtpërdrejt nga Zona e Drenicës dhe Zona Operative e Nerodimes, falënderoi të gjithë ata që kontribuan për promovimin, e veçmas,



Përkthimi i veprës madhore "Bardhësitë e Atdheut" është i domosdoshëm. Institucionet duhet ta përkrahin autorin, Afrim Mustafa në misionin e tij, thotë komandanti i mirënjohur dhe ndër më të veçantit e UÇK-së, z. Fatmir Sopi.

z. Enver Avdyli-Rafuna, drejtor i Shoqatës Humanitare, "Diaspora", z. Veprim Mustafa, pronar i kompanisë, "Arsi Cola" në Preshevë dhe Gjilan, Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës dhe sekretarin e këtij institucioni, dr. Shkëlzen Syla, Jeton Zejnullahu nga Banulla e Lypjanit, me punë në Zvicër, mjekun e mirënjohur të Luftës së UÇK, kirurg, dr. Fadil Beka, si dhe afaristin e suksesshëm, z. Enver Maliqi nga Shkupi.



Enciklopedia, me 28.777 dokumente, dëshmi dhe argument shumëshkëllore qëndron në zyrat e OVL të UÇPMB, në Kosovën Lindore, të udhëhequr nga veprimtari dhe atdhetari i mirënjohur, z. Nazmi Hajredini... Brenda kopertinave të "Bardhësitë e Atdheut", historia dhe dëshmorët e UÇPMB-së janë prezantuar me saktësi dhe me përkushtim të lartë... (Nga raporti i korrespondentit të RTK-së nga Kosova Lindore, z. Baki Rexhepi)



Mikpritje dhe prezantim i veçantë i Enciklopedisë "Bardhësitë e Atdheut" nga Televizioni Publik, MTV 2 në Shkup.

Atdheut', pasuri për çdo shtëpi të Atdheut...



"Bardhësitë e Atdheut" është vepër madhore dhe madhështore. Është, krenaria, lavdia dhe mburrja për çdo luftëtar të luftërave të UÇK-së dhe mburrje për secilin shqiptar në botë. Afrim Mustafa, meriton nderim të veçantë që na ka bërë me këtë dhuratë shumë të çmuar përjetësisht... Ta ndihmojmë autorin dhe enciklopedinë, e cila është madhështi dhe pasuri kombëtare, ka theksuar njëri nga komandantët e mirënjohur të UÇPMB-së, z. Enver Avdyli-Rafuna, po ashtu pjesëmarrës edhe në UÇK në Kosovë, UÇK, në Maqedoni, si dhe në luftën e Kroacisë.




Dr. Fadil Beka, mjeku i mirënjohur i luftës së UÇK-së, e nderon me përkushtim të lartë enciklopedinë e atdheut, me krejt dëshmorët e atdheut, të të tri luftërave të UÇK-së, por edhe me mijëra fakte dhe dëshmi, "Bardhësitë e Atdheut"... Është njëri nga çlirimtarët e rrallë, i cili thuaja çdo herë që kërkohet, nuk kursen për Librin e veçantë të trojeve shqiptare... Autori, Afrim Mustafa e falënderon me shumë nderim mjekun e vërtetë dhe humanitarin e sinqertë, dr. Fadil Beka, i cili në luftë mjekoi dhe shëroi plot e përplot luftëtarë dhe luftëtarë, duke mos kursyer as jetën për trimat e UÇK-së... Sot, në paqe, po ashtu, dr. Fadil Beka vepron, kirurg në QKUK, duke u ndihmuar pacientëve anembanë Kosovës dhe trojeve shqiptare...



OVL e UÇK, selia qendrore në Prishtinë, promovoi solemnisht enciklopedinë gjithëkombëtare, e ku u tha se "Bardhësitë e Atdheut" është dokumenti dhe argument shumë i rëndësishëm për Kosovën dhe krejt shqiptarinë, pasi këtu pasqyrohet denjësisht lavdia jonë çlirimtare dhe sakrificat nëpër shekuj... Këtu referuan: Komandanti, z. Nasim Haradinaj, historiani dr. Hakif Bajrami, veprimtari i mirënjohur, Behram Hoti, Ismail Selmani (Mala)... Në foto: Kolonel, Hajrush Kurtaj, gjeneral, Nasim Haradinaj, epror, Ismail Selmani, Autori, Afrim Mustafa dhe dr. prof. Hakif Bajrami. OVL e UÇK-së, promovimi: 28 Mars, 2017.



Gjatë promovimit të Enciklopedisë Gjithëkombëtare "Bardhësitë e Atdheut" të Autorit, Afrim Mustafa, në Ferizaj, ku kishte qindra mysafirë dhe familjarë të dëshmorëve... Aty, folën: Gjeneral Shukri Buja, Xhavit Jashari, kryetar i SHFDUÇK dhe Gafurr Bytyçi, përfaqësues i dëshmorëve nga Ferizaj, prof. dr. Ismail Hasani, por edhe të tjerë...



Mejdi Aslani, i njohur me nofkën "Komandant Plaku i Emshirit", duke nderuar enciklopedinë e trojeve të atdheut tonë, "Bardhësitë e Atdheut", duke promovuar këtë vepër kapitale, tha se, secila shtëpi e atdheut tonë duhet ta ketë këtë vepër, si informacion i vërtetë i lavdive tona... Komandant "Plaku", gjatë luftës së UÇK, më 8 mars 1999, në vetëmbrojtje të familjes dhe shtëpisë, kishte shpartalluar dhe vrarë tre policë pushtues serbë, pasi ata ishin futur me dhunë në shtëpinë e z. Mejdi Aslani, për ta arrestuar dhe burgosur bacën Mejdi dhe djemtë e tij, Asllan dhe ...



Bali Lestrani është njëri nga luftëtarët e hershëm të UÇK në Drenicë, i cili daljes në dritë të Enciklopedisë Gjithëkombëtare me krejt dëshmorët e atdheut dhe me mijëra fakte e dëshmi shekullore, "Bardhësitë e Atdheut"... Baliu, njohës dhe bashkëveprimtar i autorit, Afrim Mustafa që shumë vjet mundohet me çdo përpjekje që ta ndihmojë përparimin, ribotimin dhe promovimin e kapitalit të rëndësishëm për të gjithë shqiptarët...




"Bardhësitë e Atdheut", në duart e rekordmenit botëror, profesor, Agim Agushi nga Smira e Vitisë... Më 4 gusht të këtij viti, në qytetin e Vitisë, ky sportist me nam botëror do të demonstrojë para përfaqësuesve të Librit Ginis, me goditjen e topit me kokë, me çka deri tash ka marrë dhjetëra çmime...



Veprimtari i njohur nga Shkupi, profesori, Nuri Rexhepi, me respekt nderon enciklopedinë e trojeve shqiptare "Bardhësitë e Atdheut". Profesori, angazhohet me përkushtim, për ta promovuar dhe nderuar sa më denjësisht në Shkup, Strugë, Tetovë, Kumanovë, Dibër e gjetiu, veprën kapitale, me 28.777 dokumente dhe dëshmi gjithëkombëtare...



"Bardhësitë e Atdheut" është nder dhe krenari për të gjithë shqiptarët, thotë, luftëtar i njohur i UÇK dhe ish-zëdhënës i UÇPMB-së, Adhurim Krasniqi...



Publicisti, gazetari dhe ish-redaktori i Agjencisë së Lajmeve të luftës së UÇK-së, "Kosovapress", z. Qemal Aliu, thotë se z. Afrim Mustafa na ka ofruar informacionin më të veçantë në shqiptari, pasi ka sjellë për të gjithë ne të gjithë dëshmorët dhe heronjtë e trojeve shqiptare... Po ashtu, enciklopedia "Bardhësitë e Atdheut", përfshin edhe mijëra dokumente, dëshmi dhe fotografi nga vitet: 1878-2018...

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Challandesesi: Ndaj Çekisë luajmë për fitore

Bernard Challandesesi ka shprehur optimizëm se Kosova mund t'i marrë tri pikë në ndeshjen ndaj Çekisë dhe t'i afrohet kualifikimit në "Euro 2020", por për një gjë të tillë futbollistët "dardanë" duhet të luajnë pa presion. "Është e rëndësishme që të bëjmë një ndeshje të madhe, një ndeshje të mrekullueshme. Nëse luajmë në këtë mënyrë, edhe fitorja do të vijë", ka thënë Challandesesi



shtuar trajneri zviceran. Strategu Challandesesi ka refuzuar ta quajë përballjen në Çeki si ndeshje të jetës. "Ndeshja ndaj Çekisë absolutisht nuk është ndeshja e jetës për Kosovën, por një ndeshje ku ne duhet të kënaqemi me futbollin. Edhe pse shpresoj që lojtarët do ta bëjnë ndeshjen më të mirë në jetën e tyre, në aspektin e presionit nuk

duhet ta shohim si të tillë", ka deklaruar ai. Ajo që ka shqetësuar opinionin sportdashës në Kosovë është gjendja shëndetësore e sulmuesit kryesor Vedat Muriqi, i cili në ndeshjen e fundit të Fenerbahçes pësoi një lëndim. Lidhur me aktivizimin e sulmuesit shtatlartë, Challandesesi deklaroi: "Muriqi ka luajtur në Rizespor, por e tregoi

nivelin e tij edhe në Fenerbahçe. Ka pasur ndikim pozitiv transferimi i tij te Feneri. Jemi të kënaqur me zhvillimin e tij. Ai është paksa i lënduar, po flasim me të. Ka dhimbje, por është më mirë. Shpresojmë që deri të enjten të jetë 'ok'".

Më pas Challandesesi foli edhe për periudhën prej se është trajner i Përfaqësueses së Kosovës. Ajo "është periudha ndoshta më e kënaqshme prej se jam trajner. Për mua është nder që të punoj këtu, është kënaqësi të punoj me këta futbollistë dhe në këtë vend. Në Zvicër në fillim kanë qenë shumë skeptik me zgjedhjen që kam bërë, por tash janë bindur se kam bërë zgjedhje të duhur", përfundoi Challandesesi. "Dardanët" të hënën pasdite e zhvilluan stërvitjen e parë, kurse të enjten nga ora 20:45 e zhvillojnë ndeshjen e radhës kualifikuese Çekisë. Ndërsa më 17 nëntor në stadiumin "Fadil Vokrri" nga ora 18:00 e zhvillon përballjen ndaj Anglisë.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Përzgjedhësi i Kosovës në futboll, Bernard Challandesesi, ka thënë se "dardanët" duhet të zhvillojnë lojë të mira dhe pa presion për ta mposhtur Çekinë në ndeshjen e ardhshme kualifikuese e cila zhvillohet në Plzen të enjten nga ora 20:45. Përballja në mes të Çekisë dhe Kosovës është e vlefshme për grupin A kualifikuese për Kampionatin Evropian "Euro 2020". "Përpara kemi dy ndeshje shumë të rëndësishme. Nëse e kujtojmë shortin, kujtojmë ambientet që kemi pasur të zhvillojmë

ndeshje të mira, por jo që t'i krijojmë vetes presion të tepruar. Shumë njerëz po mendojnë se ne e kemi me patjetër të fitojmë kundër Çekisë dhe nëse nuk fitojmë, çdo gjë ka mbaruar. Nuk mendoj kështu dhe nuk e shoh atë ndeshje në atë mënyrë. Është e rëndësishme që të bëjmë një ndeshje të madhe, një ndeshje të mrekullueshme. Nëse luajmë në këtë mënyrë, edhe fitorja do të vijë", ka thënë Challandesesi, i cili ka mohuar se do t'i japë presion skuadrës për fitore. "Është e rëndësishme të mbesim të njëjtë dhe jo të ndryshojmë tani për këto dy ndeshje që e përcaktojnë fatin tonë në këto kualifikime", ka

Vushtrria e fortë për Ferizaj, Flamurtari fundos Dukagjinin

Me dy përballjet e katër skuadrave të fundit në renditjen tabelore është mbyllur java e 15-të në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Vushtrria ka shënuar fitore ndaj Ferizajt, kurse Flamurtari ka mposhtur Dukagjinin



Ishte skuadra nga Klina ajo që realizoi e para nëpërmjet Mark Milcajt (32') nga penalltia, por kuqezinjtë e kryeqytetit e barazuan rezultatit në minutën e 69, kur Shend Kelmendi shënoi nga pika e bardhë për 1-1. Golin

e fitores për Flamurtarin e shënoi Gëntit Begolli në minutat shtesë. Pas kësaj fitore, Flamurtari ngritët në kuotën e 15 pikëve, kurse Dukagjini mbetet me vetëm tetë pikë të grumbulluara.

IPKO SUPERLIGA		
Vushtrria - Ferizaj		3-1
Dukagjini - Flamurtari		1-2
Trepça '89 - Ballkani		0-0
Gjilani - Drenica		1-1
Llapi - Prishtina		1-4
Feronikeli - Drita		0-0
Tabela		
		PIKË
1. Gjilani	15	31
2. Ballkani	15	31
3. Drita	15	28
4. Prishtina	15	27
5. Llapi	15	24
6. Feronikeli	15	23
7. Drenica	15	21
8. Trepça '89	15	20
9. Flamurtari	15	15
10. Vushtrria	15	12
11. Ferizaj	15	12
12. Dukagjini	15	8
Në xhiron e radhës takohen: Ferizaj-Dukagjini, Flamurtari-Feronikeli, Drenica-Vushtrria, Prishtina-Trepça '89, Drita-Llapi, Ballkani-Gjilani.		

"Epoka e re"

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Në dy ndeshjet e fundit janë regjistruar dy fitore, një nga skuadra vendëse e të tjera nga ajo mysafire. Vushtrria ka treguar forcën në ndeshjen ndaj Ferizajt, pasi ka shënuar fitore me rezultat 3-1. Mysafirët e drejtuar nga Bekim Isufi janë mbajtur vetëm në pjesën e

parë, pasi në fillim të pjesës së dytë Bashkim Shala shënoi nga penalltia për 1-0. Jasmin Raboshta (64') dhe Ygor De Sousa (74') shënuan dy golat e tjerë për Vushtrrinë. Ndërsa golin e nderit për mysafirët e realizoi Fatih Karahoda (82'). Pas kësaj ndeshje Vushtrria ngritët në kuotën e 12 pikëve aq sa ka edhe skuadra e Ferizajt. Fitores i është gëzuar edhe Flamurtari që e mposhti Dukagjinin (1-2).

Prekazi publikon listën kundër Austrisë



PRISHTINË, 11 NËNTOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses U21, Rafet Prekazi, e ka bërë publike listën e futbollistëve me të cilët do t'i kundërvihet Austrisë në ndeshjen e radhës kualifikuese për Kampionatin Evropian që zhvillohet më 15 nëntor në Ried. U21-shat kanë mungesa të shumta. Arbenit Xhemajli është i grumbulluar me Përfaqësuesen A, Besfort Kolgeci, Kreshnik Hajrizi, Arton Zekaj dhe Lirim Kasrati

(Bologna) janë të lënduar, kurse Leard Sadriu është grumbulluar me U19-shtat për kualifikimet në Uells. Ndërsa për herë të parë pjesë e Kosovës U21 do të jenë Lumbardh Dellova nga Hajduku dhe Ismajl Beka nga FC Wil 1900, Donat Rudhani nga FC Aarau, Luftëtar Mushkolaj nga TSV 1860 Rosenheim, Meriton Kastrati nga SC YF Zurich, Arb Manaj nga FC Trepça '89 dhe portieri i FC Dritës, Dorart Ramadani.

LISTA E FUTBOLLISTËVE	
Florian Smakiqi, Ardit Nika, Dorart Ramadani, Cendrim Kameraj, Lonat Vitija, Ismajl Beka, Meriton Kastrati, Fuad Rahimi, Valon Hamdiu, Enit Sadiku, Lumbardh Dellova, Donat Rudhani, Gezim Pepsi, Ismet Lushaku, Eris Abedini, Blend Baftiu, Arbër Hoxha, Ardit Gashi, Lirim Kastrati, Arbnor Muja, Arb Manaj, Luftëtar Mushkolaj, Mirlind Daku, Valdrin Mustafa.	

Në Zvicër e bëjnë punë të kryer kalimin e Xhakës në Milan

LONDËR, 11 NËNTOR - Kapitani i Kombëtares së Zvicrës, Granit Xhaka, është një hap pranë skuadrës së njohur italiane AC Milan. Lajmi është bërë me dije nga media zvicerane "RSI",

e cila konfirmon se lojtari është duke kërkuar shtëpi në qytetin e Milanos. Skuadra kuqezi është shumë pranë marrëveshjes me Xhakën, i cili duket me një këmbë jashtë Arsenalit, pasi

tashmë dihet për "konfliktin" e hapur mes 27-vjeçarit me trajnerin dhe tifozët e Arsenalit, kështu që largimi do të ishte e vetmja zgjidhje. Fakti që ai është duke kërkuar shtëpi

në Milano, e përforcon edhe më shumë faktin, se Xhaka pritet të transferohet te kuqezinjtë, të cilët po kalojnë një krizë rezultatesh në këto javë në Serinë A.



Uzuni: Jam krenar që i përfaqësoj ngjyrat kuqezi

TIRANË, 11 NËNTOR - Shqipëria do të luajë përballë Andorrës dhe Francës në dy ndeshjet e fundit të kualifikueseve të Evropianit. Këto takime do të shërbejnë për ta konsoliduar përfundimisht grupin e Rejës dhe për ta rritur entuziazmin sa iu përket kualifikuesve të radhës, pasi shenjat e para pozitive janë dhënë. Në konferencën për shtyp kanë qenë të pranishëm edhe dy lojtarët kuqezinj, Emanuele Ndoji dhe Myrto Uzuni. Ky i fundit është shprehur se për të mjafton që të vijë ftesa nga Kombëtarja, pa pasur shumë rëndësi se ku gjendet në të. "Është tjetër gjë klubi dhe tjetër gjë kur vjen te Kombëtarja. Kjo të jep më shumë besim kur grumbullohesh nga Shqipëria. Nuk jam zhgënjyer kur nuk më erdhi ftesa, por nuk ndihesha mirë përbrenda. Reja më thirri pasi e ka parë që kam luajtur gjithmonë te Lokomotiva e Zagrebit. Ftesa është aty dhe nuk mungon.



Trajneri nuk mund t'i japë llogari lojtarit që përse nuk e thërret. Unë dua t'i luaj të gjitha ndeshjet. Mjafton të jesh pjesë e listës te Shqipëria, mjafton të jesh pjesë e saj. Nuk ka rëndësi nëse je te kryesorja apo tek e pritjes. Tani jemi në 'Arenën Kombëtare', shtëpinë tonë të re dhe do ta kemi mbështetjen e tifozëve", ka thënë Uzuni. Ndërsa Emanuele Ndoji ka

shtuar: "Jam më mirë fizikisht, pasi kam qenë për tre muaj jashtë fushës. Kam luajtur pak minuta me Brescian, por tani jam te Kombëtarja dhe është mundësi e madhe që më jepet. Konkurrenca në ekip është shumë e mirë dhe duhet të japësh gjithçka në stërvitje, që t'i tregosh Rejës që je gati. Ne jemi futbollistë profesionistë dhe mendja jonë është tek Andorra".

Kampionët e Torontos triumfojnë ndaj lakersave

LOS ANGELES, 11 NËNTOR - Skuadra kampione e Torontos fitoi 113-104 ndaj lakersave, në një përballje gjigantësh, mes ekipit kampion dhe skuadrës kryesuese në Perëndim. Lakersat dominuan në ndeshje shumicën e kohës, por në fund u detyruan ta "hapin krahun". Davis realizoi 27 pikë, ndërsa LeBron Jamesi e mbylli me një "triple double" (13 pikë, 13 rebounde e 15 asistime), por që mbetën për statistikë. Për Toronton u dalluan Siakam me 24 pikë dhe 11 rebounde e VanVleet me 23 pikë e 10 asistime. Skuadra e Milwaukee, falë 35 pikëve e 16 reboundeve të Giannis Antetokounmpo, mposhti 121-119 Oklahomën, ndeshje me rivalitet dhe emocione deri në



fund. Fiton edhe skuadra e Clevelandit, që mundi 108-87 New-Yorkun jashtë fushës (Sexton 31 pikë), ndërsa Philadelphia triumfoi 114-106 ndaj Charlottes (Embiid 18 pikë). Pas kohës shtesë triumfon skuadra e Denverit që mundi 100-98 Minnesotan, sukses që

ngjit Nuggetsin në krye të renditjes në Perëndim. Të pestë titullarët e Denverit realizuan mbi 13 pikë (Jokiçi 20 pikë). Koha shtesë i ka buzëqeshur edhe Portlandit, që triumfoi 124-113 ndaj Atlantës (Lillard 30 pikë), ndërsa Phoenixi mposhti 138-112 Brooklyn (Bookeri 27 pikë).

SHKURT

Kushtrim Bajraktaraj, nënkampion i botës në Dubai

Kushtrim Bajraktaraj është kthyer me medalje nga Kampionati Botëror i Bodybuildingut në Dubai. Kushtrim Bajraktaraj s'ka të ndaluar në sukseset e tij në arenën ndërkombëtare të bodybuildingut. Kampioni i shumëfishtë i Kosovës ka arritur të fitojë edhe një medalje të rëndësishme, duke u veçuar në mesin e 27 garuesve. Bajraktaraj është shpërblyer me medaljen e argjendtë në kategorinë deri në 80 kilogramë në Kampionatin Botëror të Bodybuildingut të zhvilluar në Dubai. Ky është një tjetër sukses i radhës për Bajraktarajn i cili, së fundmi, kishte fituar edhe medaljen e bronzitë në Ifbb Diamond Cup Maqedoni 2019, madje duke garuar me konkurrencë mbi kategorinë e tij.

Enrique, afër Arsenalit

Luis Enrique mund të jetë trajneri i ri i skuadrës së Arsenalit. Lajmi është bërë me dije të hënën nga mediet në Angli. Unai Emery nuk po arrin rezultate të mira me Arsenalin dhe ish-trajneri i Spanjës, Luis Enrique, po shihet si zgjedhje ideale. Strategu spanjoll ka drejtuar edhe disa klube, në mesin e të cilave Barcelonën dhe Romën.

Barça në telashe, Semedo mungon pesë javë

Probleme në mbrojtje për trajnerin e Barcelonës, Ernesto Valverde, i cili duhet të bëjë llogaritë pa Nelson Semedo në prapavijë. Mbrojtësi u dëmtua në sfidën ndaj Celta Vigos, të cilën katalanasit e fituan me rezultatin 4-1. Lojtari u zëvendësua në minutën e 23-të, pas një dëmtimi në pulpën e këmbës së majtë. 25-vjeçari iu nënshtrua menjëherë vizitave mjekësore të cilat konfirmuan dëmtimin. Sipas mjekëve, koha e rikuperimit të futbollistit mendohet të jetë rreth pesë javë, duke vënë në dyshim pjesëmarrjen e lojtarit në sfidën e 10 dhjetorit në Ligën e Kampionëve ndaj Interit.

Juve ofron katër lojtarë për Pogban

Skuadra kampione e Italisë, Juventus, është e interesuar që ta rikthejë Paul Pogban në Torino. Sipas medieve në ishull, "Zonja e Vjetër" është e gatshme të ofrojë katër lojtarë në mënyrë që t'i bindë drejtuesit e Manchester Unitedit të heqin dorë nga francezi Pogba. Lojtarët që Juve mendon t'i sakrifikojë për Pogban janë Mario Mandzukiq, Emre Can, Blaise Matuidi dhe Merih Demiral.

PSG-ja vendos ta blejë Icardin

Sulmuesit Mauro Icardi i kanë mjaftuar vetëm dhjetë ndeshje për të shënuar 9 gola, 5 në kampionat dhe 4 në Ligën e Kampionëve, por edhe për t'i fituar zemrat e tifozëve të Paris Saint Germainit dhe për të triumfuar në duel me Edinson Cavanin. Icardi po kalon një çast të artë në karrierën e tij dhe, sipas medieve italiane, në fund të sezonit PSG-ja do të ushtrijë të drejtën e blerjes nga Interi për 70 milionë euro.

Wengeri: Arsenali ka tentuar t'i transferojë Messin dhe Piquen

Arsene Wenger ka zbuluar se Arsenali vite më parë kishte tentuar t'i transferonte Lionel Messin dhe Gerard Piquen nga Barcelona. Pasi Cesc Fabregas po shkëlqente në fillimet e karrierës në "Emirates", "The Gunners" kishte tentuar të ndërtonte një skuadër të fuqishme me transferimin e argjentinasit dhe spanjollit. Wengeri ka zbuluar se ata tentonin më pas ta merrnin edhe Messin e Piquen. "Ne tentuam, por nuk ishim afër transferimit të Messit", ka thënë Wenger në një intervistë për "beIN Sports". "Por, ne tentuam t'i transferonim Piquen, Messin, por morëm vetëm Fabregasin, sepse ata kishin filluar të shkëlqenin", ka thënë Wenger. "Mos ta harrojmë finalen e Ligës së Kampionëve në vitin 2006, atëherë kur luajtëm me Barcelonën, Messi nuk arriti të luante shkaku i lëndimit... kështu që para 13 vjetësh ai tashmë luante standard. Çfarë ka bërë ky djalë, është e pabesueshme", ka shtuar Wengeri.

REZULTATET

Minnesota - Denver	98-100
Orlando - Indiana	102-109
Philadelphia - Charlotte	114-106
Oklahoma - Milwaukee	119-121
New York - Cleveland	87-108
Phoenix - Brooklyn	138-112
Portland - Atlanta	124-113
Lakers - Toronto	104-113



KONKURS PUNE PËR PERIUDHË TË CAKTUAR KOHORE (4 muaj)

Titulli i vendit të punës: Zyrtar për Administratë dhe Personel

Ndërmarrja: Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës SHA

Afati për aplikim: 18.11.2019 ora 16:00

PËRSHKRIMI NDËRMARRJES

NKEC është Ndërmarrje Qendrore Publike e themeluar sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike, me vendim të Qeverisë: Nr. 07/47 dt.15.05.2018

Detyrat dhe përgjegjësitë

Bën planifikimet e nevojshme, publikimet dhe shpalesjet para autoriteteve kompetente.

Të kujdeset për respektimin e politikave të avancuara në përgatitjen e personelit, procedurave administrative, TI, Logjistikë, Arkiv etj.

Kryen detyra tjera të caktuara nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Kërkesat profesionale/

Diplomë Bachelor në shkenca shoqërore. Diploma Master do të konsiderohet përparësi.

Së paku 5 vite përvojë pune profesionale. Përvoja në organizata qeveritare dhe/ose ndërkombëtare që kanë të bëjnë me energjinë do të jetë përparësi.

Njohja e gjuhës angleze do të jetë përparësi.

Aplikimi

Formulari i aplikimit mund të kërkohej në e-mail: info@nkec-energy.com

Formulari dhe dokumentacioni shtesë të dorëzohen në e-mail: info@nkec-energy.com,

ose direkt në adresën: Rr. Bedri Pejani Nr.17 / 18, kati 2, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës sh.a. ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim gjinie dhe përkatësie kombëtare.



KONKURS PUNE PËR PERIUDHË TË CAKTUAR KOHORE (4 muaj)

Titulli i vendit të punës: Zyrtar për financa dhe kontabilitet

Ndërmarrja: Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës SHA

Afati për aplikim: 18.11.2019 ora 16:00

PËRSHKRIMI NDËRMARRJES

NKEC është Ndërmarrje Qendrore Publike e themeluar sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike, me vendim të Qeverisë: Nr. 07/47 dt.15.05.2018

Detyrat dhe përgjegjësitë

Mban llogaritë e Kompanisë, llogarit pagesat e tatimeve, pagave etj.

Përgatitë raporte në përputhje me rregulloret dhe ligjet në fuqi.

Kryen detyra të tjera të caktuara nga Kryeshefi Ekzekutiv

Kërkesat profesionale/

Diplomë Bachelor në Biznes, Financa ose Kontabilitet. Diploma Master do të konsiderohet përparësi.

Së paku 5 vite përvojë pune profesionale; Përvoja në organizata qeveritare ose ndërkombëtare që kanë të bëjnë me energjinë do të jetë përparësi. Njohja e gjuhës angleze do të jetë përparësi.

Aplikimi

Formulari i aplikimit mund të kërkohej në e-mail: info@nkec-energy.com

Formulari dhe dokumentacioni shtesë të dorëzohen në e-mail: info@nkec-energy.com,

ose direkt në adresën: Rr. Bedri Pejani Nr.17 / 18, kati 2, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës sh.a. ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim gjinie dhe përkatësie kombëtare.



KONKURS ZA ZAPOSLENJE NA ODREDJENO VREME (4 meseca)

Naziv posla: Službenik za Administraciju i Personel

Kompania: Novo Preduzece za Energiju Kosova AD

Rok za apliciranje: 18.11.2019, do 16:00 h

OPIS PREDUZECA

NKEC je centralno preduzece u javnom vlasnistvu osnovano prema Zakonu o Javnim Preduzecima, Odlukom Vlade br. 07/47 dt.15.05.2018

Obaveze i Odgovornosti

Obavlja neohodno planiranje, publikacije i objave nadležnim orgaima.

Brine se za pridržavanje naprednih politika u pripremi osoblja, administrativnim procedurama, IT-u, logistici, arhivima itd .

Vrši druge dužnosti koje mu dodeljuje glavni Izvršni Direktor.

Profesionalni Zahtevi /

Diploma Bachelor stepen društvenih nauka. Diploma Master će se smatrati prednost.

Najmanje 5 godina profesionalnog radnog iskustva. Iskustvo u vladinim / ili međunarodnim organizacijama koje se bave energijom biće prednost.

Poznavanje engleskog biće prednost.

Apliciranje

Formular prijave može se potražiti preko e-mail adrese: info@nkec-energy.com

Formular prijave i dodatnu dokumentaciju dostaviti ne email: info@nkec-energy.com,

ili direktno na adresi: Ul. Bedri Pejani, Broj 17 / 18, II sprat, 10000, Priština, Republika Kosovo.

Novo preduzeće Kosovo AD pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova bez razlike na pol ili nacionalnu pripadnost.



KONKURS ZA ZAPOSLENJE NA ODREDJENO VREME (4 meseca)

Naziv posla: Službenik za finansije i računovodstvo

Kompania: Novo Preduzece za Energiju Kosova AD

Rok za apliciranje: 18.11.2019, do 16:00 h

OPIS PREDUZECA

NKEC je centralno preduzece u javnom vlasnistvu osnovano prema Zakonu o Javnim Preduzecima, Odlukom Vlade br. 07/47 dt.15.05.2018

Obaveze i odgovornosti

Vodi račune preduzeća, obračunava poreze, plate itd.

Pripremite izveštaje u skladu sa važećim propisima i zakonima.

Vrši druge dužnosti koje mu dodeljuje glavni izvršni direktor

Profesionalni Zahtevi

Bachelor diploma iz biznisa, finansija ili računovodstva. Magisterij će se smatrati prednostom.

Najmanje 5 godina profesionalnog radnog iskustva; Iskustvo u vladi ili međunarodnim organizacijama koje se bave energijom biće prednost. Poznavanje engleskog biće prednost.

Apliciranje

Formular prijave može se potražiti preko e-mail adrese: info@nkec-energy.com

Formular prijave i dodatnu dokumentaciju dostaviti ne email: info@nkec-energy.com,

ili direktno na adresi: Ul. Bedri Pejani, Broj 17 / 18, II sprat, 10000, Priština, Republika Kosovo.

Novo preduzeće Kosovo AD pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova bez razlike na pol ili nacionalnu pripadnost.

Njoftim për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Drenica"

Komuna: Skenderaj

Data: 11.11.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/107-CS/1.2	Trajnim: Përdorimi i teknologjise në mësimdhënie

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shfmu "Drenica" Polac, Skenderaj. Objektivi i nën-komponentit 1.1. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe përsonele të shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK). Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: "Drenica" Polac, Skenderaj, më së largu deri më datën; 19.11.2019 Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Gëzim Gashi
Telefoni: 044408003
E-maili: gëzim.gashi@hotmail.com



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Nr: 06-111-157230
Datë: 11.11.2019

Në bazë të kërkesës së Drejtorisë për Arsimit dhe Shkencë për protestim ndryshim të konkursit nr. nr.01-111-154376, i datës: 04.11.2019 zyra e personelit lëshon këtë:

NJOFTIM**Plotësim / Ndryshimi i konkursit për këto vende pune:**

1. Mësimdhënës Klasor (me kohe të pacaktuar) në SHFMU "Luigj Gurakuqi" në Nashec, ndryshohet/plotësohet në vend të SHFMU "Luigj Gurakuqi" në Nashec është SHFMU "Fatmir Berisha" në Prizren
2. Mësimdhënës Klasor (me kohe të caktuar) në SHFMU "Dy Deshmoret" në Piranë ndryshohet/plotësohet në vend të SHFMU "Dy Deshmorët" në Piranë është SHFMU "Nazim Kokollari në Prizren
3. Një Mësimdhënës për Lenden Matematik me 15 orë në SHFMU "Lidhja Prizreni" në Prizren dhe në lëndën e TIK-ut me 7 orë, ndryshohet/plotësohet një mësimdhënës në SHFMU "Lidhja e Prizreni" në Prizren në lëndën Matematik-TIK me 20 orë mësimore (me kohë të pacaktuar).
4. Një mësimdhënës në SHFMU "Bajram Curri" në Prizren, ndryshohet/plotësohet një mësimdhënës për lëndën e edukatës qytetare me 10 orë mësimore në SHFMU "Bajram Curri" në Romajë. (me kohe të pacaktuar)

Si dhe anulohen këto vende pune:

1. Një mësimdhënës në lëndën Edukatë Muzikore në SHFMU "Ibrahim Fehmiu" në Prizren.
2. Një mësimdhënës për lëndën Art Figurativ në SHFMU "Abdyl Frashëri" në Prizren (me kohë të caktuar).

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Vaso Pashë Shkodrani"

Komuna: Suharekë

Data: 12.11.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/127 - CS/1.1	Trajnim: Puna e kujdestarit të klasës – kujdestari i mirë"

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shfmu "Vaso Pashë Shkodrani" Leshan, Suharekë. Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Metodiko-Didaktik, "Edukimi Inkluziv"

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e dy kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe përsonele të shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e trajnimeve Per zhvillim profesional te mesimdhenesve (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo "Per zhvillim profesional te mesimdhenesve (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)


Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK). Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: Shfmu "Vaso Pashë Shkodrani" Leshan, Suharekë, më së largu deri më datën; 20.11.2019. Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Jeton Vranovci

Tel: 044/254149 E-maili: jetonvranovci@hotmail.com

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Laboratori i dhëmbëve "Alpim" shpall të pavlefshme certifikatën e regjistrimit të biznesit më numër: 80665458, të lëshuar nga MTI-ja Prishtinë.

► Xhafer Plaqiqi shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit të UP-së, Fakulteti Ndërtimtar dhe Arkitekturë drejtimi Arkitekturë me nr. 1137

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

